Ndërsa, në vargun e fundit, “Tri herë në ditë,” Deva e konkretizon mesazhin e tij, duke përcaktuar një ritëm ditor për këtë veprim të thjeshtë, por të rëndësishëm. Ky përshkrim e bën poezinë më konkrete dhe iu ndihmon fëmijëve ta kujtojnë më lehtë këshillën, duke e shndërruar atë në një zakon të mirë. Kështu, poeti sjell përpara lexuesit një edukim të qëndrueshëm përmes përsëritjes, por gjithashtu ndërtimin e një përgjegjësie të vogël, një mësim për të ruajtur shëndetin e dhëmbëve. Përsëritja “tri herë në ditë” jo vetëm që i referohet një rekomandimi konkret higjienik, por edhe një akti që krijon disiplinë dhe përkujdesje.

Pra, në këto vargje ai e përdor figurën e nënës si një simbol të dashurisë dhe përkushtimit, duke e vendosur atë në qendër të një mesazhi të thjeshtë, por të fuqishëm për rëndësinë e kujdesit personal. Duke e kthyer larjen e dhëmbëve, një veprim të përditshëm, në një akt dashurie dhe kujdesi të përzemërt, Deva arrin të krijojë një përvojë të veçantë poetike që tejkalon kufijtë e këshillave praktike dhe hyn në botën e përjetimeve familjare.

Në këtë kontekst Deva përmes zgjedhjes së kujdesshme të fjalëve dhe një stili të butë, e ndërthur elementin edukativ me ndjeshmërinë dhe imagjinatën. Ai e përdor vargun për të krijuar një ndjesi ngrohtësie dhe siguri, duke e transformuar larjen e dhëmbëve në një ritual të bukur dhe domethënës, i cili ushqen lidhjen mes fëmijës dhe prindit.

Duke u bazuar në analizat e vargjeve të mësipërme, atëherë mund të themi se Agim Deva ka përdorur imagjinatën për ta kthyer në një mesazh të thjeshtë, por edhe real, në një përvojë të këndshme letrare dhe edukative. Duke përdorur një stil të butë dhe një gjuhë të qartë, ai e ndihmon lexuesin e ri ta kuptojë dhe ta pranojë mesazhin jo vetëm si këshillë, por si një pjesë të dashurisë dhe kujdesit të përditshëm. Mesazhi i tij, në thelb, është një kombinim i thjeshtësisë dhe thellësisë, ku imagjinata i shërben edukimit, duke u kthyer në një vegël të vlefshme për të formuar zakone të shëndetshme dhe për të ndërtuar marrëdhënie të forta familjare përmes poezisë.

Në përgjithësi, realja dhe imagjinata në letërsinë e shkrimtarit për fëmijë, Agim Deva, është një forcë krijuese që i jep jetë botëve të reja, sfidon normat dhe hap horizonte të panumërta. Shembull konkret: Një vjershë që mund të analizohet për ndërlidhjen e reales dhe imagjinatës është “Pikniku i rrugës”, një tregim që përmes elementeve poetike dhe personazheve të fuqishme autori kap elementet e jetës së përditshme duke i kombinuar me momente simbolike dhe të ngarkuara me tension imagjinar, si dhe duke përdorur një stil që i bashkon dy botë paralele – reale dhe imagjinatën.

Realja dhe imagjinata në portretizimin e nënës

Në poezinë e Agim Devës, figura e nënës ndriçohet nëpërmjet një ndërthurjeje të thellë mes reales dhe imagjinatës. Deva arrin të trajtojë nënën si një figurë që njëkohësisht i përket jetës së përditshme dhe një sferë të idealizuar, duke përfaqësuar jo vetëm përjetimet personale të poetit, por edhe ndjesitë e përbashkëta të lexuesve. Kjo ndërthurje e reales dhe imagjinatës thekson vlerat e nënës si një simbol të përjetshëm dashurie dhe sakrifice. Kjo shprehet edhe në vargjet që i kushtohen në tërësi nënës:

Puthjen e parë - Nënës.
Lulen e parë - Nënës.
Vizatimin e parë - Nënës.
Letrën e parë - Nënës.
Të fshehtë e parë - Nënës.
Se nëna më lindi,
Mua ne maj
Dhe askush tjetër,
S'më lindi përveç saj⁸

Në trajtimin e nënës si një figurë reale, Deva fokusohet tek përvoja e përditshme dhe sakrifica konkrete e nënës në jetën e tij dhe të komunitetit. Ajo përshkruhet si një grua e thjeshtë, e cila përballon vuajtjet dhe sakrificat për të rritur fëmijët e saj dhe për të ruajtur vlerat familjare. Këto momente reale shfaqen nëpërmjet detajeve të thjeshta, të tilla si përkujdesja e saj për shtëpinë, vëmendja ndaj nevojave të fëmijëve, dhe puna e përditshme për mbijetesë. Kështu, nëna e Devës bëhet një figurë reale, një qenie e prekshme, që mishëron vështirësitë dhe bukuritë e jetës njerëzore.

Përmes kësaj qasjeje realiste, Deva arrin të krijojë një lidhje të drejtpërdrejtë me lexuesin. Shumë shqiptarë mund ta identifikojnë nënën e tyre në këtë përshkrim të nënës së Devës, duke ndier dhembshuri dhe respekt për gratë që, me përkushtim të palodhur, mbajnë familjet dhe traditat gjallë. Nëna e tij nuk është thjesht një figurë poetike, por një model universal i gruas shqiptare që përballon sfidat e jetës me krenari dhe dashuri të pakushtëzuar.

Ndërsa realja pasqyron anën konkrete të jetës së nënës, imagjinata e Devës e ngre figurën e saj në një nivel të lartë idealizimi, duke e kthyer atë në një simbol të dashurisë së përjetshme dhe të sakrificës sublime. Në poezi, ajo merr përmasa pothuajse mitike, duke u përjetësuar si një shenjtore apo mbrojtëse e përhershme e fëmijëve dhe familjes. Në këtë mënyrë, Deva e shtrin ndikimin e nënës përtej kohës dhe hapësirës fizike, duke e bërë atë të pranishme gjithmonë, edhe kur nuk është më e gjallë.

Imagjinata e Devës shpesh e portretizon nënën si një figurë hyjnore, ku ajo është e afërt me tokën, natyrën dhe përjetësinë. Në këtë kontekst, nëna është më shumë se një individ; ajo është një princip i përhershëm dhe i shenjtë që ruan lidhjen e fortë mes brezave dhe tokës amtare. Kjo qasje idealizuese shpesh kalon në sferën mistike, ku nëna përfaqëson një frymë të përjetshme të kujtesës dhe dashurisë. Pra, në poezitë e tij, Agim Deva shpesh e paraqet nënën si personifikim të sakrificës. Ajo është figura që gjithmonë përballon vështirësitë e jetës pa u lodhur, për hir të familjes dhe fëmijëve të saj. Deva i kushton momente të veçanta sakrificave

⁸ Vargje nga poezia “Nënës”

të nënës, duke e përshkruar atë si një hero të heshtur, që në mënyrë të pavetëdijshme i jep kuptim fjalës “dashuri”. Nëna sakrifikon të mirat e saj personale për lumturinë e fëmijëve dhe ruajtjen e traditave e vlerave familjare. Ajo përballon vështirësitë ekonomike dhe sociale, duke u bërë burim shprese dhe force për të gjithë ata që kanë nevojë për mbështetje, e në veçanti për fëmijët e saj, e që kjo pasqyrohet edhe në vargjet në vijim:

Nënëz, ma jep dorën!
Ma jep edhe mua!
Nënëz, ma jep dorën,
Se edhe unë të dua!
Tre fëmijë ka nëna
Të gjithë njësoj i do,
Secili prej tyre
Dorën i kërkon⁹.

Në këto vargje, autori pasqyron një ndjenjë të thellë të vështirësisë dhe dilemës me të cilën përballlet një nënë. Përmes kësaj ndërthurjeje, Deva i jep lexuesit një eksperiencë të dyfishtë: një përkujtesë të jetës reale dhe konkrete të nënës, si dhe një frymëzim për përmasat e mëdha që mund të marrë dashuria e saj përmes imagjinatës. Kjo qasje e ndihmon lexuesin të shohë figurën e nënës jo vetëm si një person të dashur, por edhe si një simbol që tejkalon dimensionet e zakonshme të përditshmërisë dhe që mbart një rëndësi të përjetshme për të gjithë njerëzit e në veçanti për fëmijët e saj, sikur në vijim:

Tre fëmijë ka nëna,
Por ka veç dy duar
Kujt t'ia japë më parë
Dorën e praruar?
Iu hodh në përqafim¹⁰

Shprehja “tre fëmijë ka nëna por ka veç dy duar” sugjeron kufizimin dhe pamundësinë e saj për t'i mbështetur të gjithë njësoj në të njëjtën kohë, ndërsa “dorën e praruar” mund të nënkuptojë mbështetjen, ndihmën ose kujdesin e saj të vlefshëm. Kjo dilemë shpesh shihet si metaforë për përpjekjet e jetës dhe zgjedhjet e vështira që duhet të bëjmë në rrethana të pamjaftueshme apo të ndërlikuara. Ndoshta autori dëshiron të shprehë se dashuria dhe kujdesi mund të jenë të pakufizuara shpirtërisht, por përkrahja praktike shpesh është e kufizuar nga kushtet fizike apo materiale.

⁹ Poezia “Dy duar, tre fëmijë” – Rilindja, 1984

¹⁰ Nga e njëjta poezi

Pra, figura e nënës në poezinë e Agim Devës është një sintezë e pasur dhe e ndërlikuar e reales dhe imagjinatës, duke paraqitur një grua që është njëkohësisht një qenie e thjeshtë e përkushtuar ndaj familjes dhe një simbol i dashurisë së përjetshme. Deva e sjell nënën jo vetëm si një qenie që ekziston në këtë botë, por edhe si një ideal që rrezaton tej çdo kufiri të jetës njerëzore. Kjo ndërthurje i jep fuqinë poetike figurës së nënës, duke e bërë atë një figurë të dashur për lexuesit dhe një pasqyrim të thellë të përvojës njerëzore dhe kulturore shqiptare.

Nga kjo që u tha deri më tani, mund të theksojmë se imagjinata është një aspekt thelbësor që i jep letërsisë së Agim Devës një ndjesi të veçantë poetike dhe fantastike. Në veprat e tij, imagjinata pasqyron një botë ku ëndrrat dhe vizionet shpesh ndërhyjnë me realitetin. Deva përdor simboliken dhe shpesh krijon skena të fuqishme metaforike që i japin lexuesit një përvojë të re, duke thyer kufijtë e reales dhe duke përforcuar temën e reflektimeve të brendshme të karaktereve të tij.

Vlerësimi për Agim Devën thekson rolin dhe kontributin e tij të veçantë në letërsinë shqipe për fëmijë, duke e pozicionuar atë si një autor që arriti nivele të larta artistike dhe cilësore në këtë fushë, duke e zgjeruar dhe pasuruar letërsinë për fëmijë nga një perspektivë e re dhe e pasur për lexuesit shqiptarë në fund të viteve të gjashtëdhjeta dhe fillimin e viteve të shtatëdhjeta. Shumë studiues dhe shkrimtarë theksojnë se në letërsinë për fëmijë, Agim Deva ka arritur një standard të lartë, duke u dalluar për stilin e tij të veçantë dhe përmbajtjen e pasur. Kjo cilësi në veprat e tij është theksuar edhe nga kritikët dhe lexuesit, duke vënë në dukje aftësinë e tij për të krijuar botë të plota, me personazhe të thella e dinamike që fëmijët mund t'i përjetojnë e kuptojnë lehtë, por që bartin gjithashtu mesazhe edukative. Nëpërmjet një gjuhe të thjeshtë por poetike, Deva ka ndërtuar një stil që rezonon natyrshëm me botën e fëmijëve dhe krijon një lidhje të afërt midis lexuesve të rinj dhe temave të trajtuara. Për shkrimtarin Pandeli Koçi, jeta dhe vepra e Agim Devës, janë një pasqyrë e gjallë e një intelektualit dhe krijuesi që gjithë jetën ia kushtoi letërsisë shqipe dhe edukimit të brezit të ri. Koçi, gjithashtu thekson se vepra letrare për fëmijë e Agim Devës “shënoi vlerat më të larta cilësore në krahun verilindor të letërsisë shqipe”¹¹. Në këtë mënyrë, Deva jo vetëm që i ka dhënë letërsisë shqipe për fëmijë vlera cilësore, por ka kontribuar në rritjen e saj si një letërsi që edukon dhe fuqizon brezat e rinj.

Pra, temat dhe tregimet e tij u japin lexuesve një përvojë të re, duke përfshirë edhe elemente të fantazisë dhe imagjinatës, që janë jetike për zhvillimin kreativ të fëmijëve. Ai u ofron fëmijëve një pasqyrim të vetvetes dhe të kulturës së tyre përmes personazheve duke u futur në një univers më të gjerë që i ndihmon të imagjinojnë. Në këtë kuptim, kontributi i tij është jetik për ndërtimin e një letërsie që shpreh identitetin dhe kulturën shqiptare në mënyrë të thellë dhe të qëndrueshme për fëmijët. Ai luan me personazhet më të dashura që fëmijët i kanë në zemër, duke futur në vjershat e tij personazhe nga natyra, kafshët, insektet e të tjera:

¹¹ Pandeli Koçi - Nderim për shkrimtarin e mirënjohur, Agim Deva, 2009, f. 19.

Në livadhe del e vogla bletë
Në gjethe të njoma herët ulet
Dhe n'mes ditë kur bëhet nxehtë
Me buzë t'vogla i puth lulet¹²

Në këto vargje, poeti përshkruan me delikatesë dhe dashuri jetën e një blete të vogël, duke i dhënë asaj cilësi njerëzore dhe një përkushtim të thellë ndaj natyrës. Ai përdor fjalë të ëmbla dhe imazhe të ngrohta për të krijuar një atmosferë idilike dhe të qetë, duke treguar dashurinë dhe harmoninë e bletës me natyrën që e rrethon. Përmes fjalës “puth,” poeti shpreh kujdesin dhe respektin e saj për lulet, duke na kujtuar rëndësinë e përkujdesjes ndërmjet njeriut dhe natyrës, si dhe përkushtimin e bletës për t'i dhënë jetë botës përreth saj.

Siç shihet edhe në këto vargje, poeti përdor një kombinim të reales dhe imagjinatës. Në aspektin real, ai përshkruan sjelljen e bletës, që del në livadhe, ulet mbi gjethe e njoma dhe mbledh nektarin nga lulet. Kjo është një pamje e zakonshme dhe e natyrshme e një blete në botën reale. Ndërkohë, përmes imagjinatës, poeti i jep bletës cilësi njerëzore: ajo “puth” lulet me “buzë të vogla.” Kjo është një përfytyrim poetik që i shton vargut një ndjesi ëmbëlsie, duke e bërë skenën më të ngrohtë dhe emocionale. Në këtë mënyrë, poeti krijon një lidhje të veçantë mes reales dhe imagjinatës, ku bleta simbolizon përkushtimin dhe dashurinë e njeriut ndaj natyrës, ndërsa detajet e vogla të sjelljes së saj e bëjnë atë të duket si një qenie e dashur dhe e gjallë në sytë e lexuesit.

Në disa vjersha autori përmes ironisë dhe imazheve të fuqishme krijon një përshkrim që përball lexuesin me kufijtë e fantazisë përballë realitetit të pamëshirshëm.

Nuk besoj se ka ndonjë fëmijë
Që kish mundur malin ta përbijë
Pesë mijë kile gërdhnela druri
Gjysmë vagoni thëngjill guri¹³

Këto vargje, në formën e një satire të lehtë dhe të shprehjes popullore, krijon një kontrast mes fuqisë imagjinative të fëmijëve dhe realitetit të ashpër të mjedisit fizik. Kjo ide përforcohet nga fakti që fëmija, simbol i pafajësisë dhe i fantazisë pa kufi, vihet përballë një mali, një force të pashmangshme dhe të rëndë si guri e druri. Ironia në këto vargje vjen nëpërmjet përshkrimit të një misioni të pamundur, një përpjekje pothuaj mitike, ku fëmija shihet si hero që sfidon natyrën. Kjo përplasje mes reales dhe imagjinatës vjen në formën e pyetjes retorike, që duket se e nxit lexuesin të mendojë për kufijtë e njeriut dhe fuqinë e ëndrrës, megjithëse nuk është realiste që një fëmijë të përmbushë një detyrë të tillë. Megjithatë,

¹² Poezia “Zonja e livadheve” – botuar në vitin 1968

¹³ Vargje nga poezia “Kush e përbin malin”

nëpërmjet kësaj pamundësie të zbkuruar, vargjet lënë të kuptohet se, edhe pse njerëzit mund të kenë dëshira e ëndrra të mëdha, ekziston një kufi që duhet pranuar si pjesë e natyrës njerëzore.

Kjo qasje gjithashtu flet për një dimension social të përmbajtur; mund të lexohet si një kritikë ndaj kërkesave që shpesh i bëhen të rinjve për të përballuar sfida të mëdha që janë jashtë mundësive të tyre reale. Pra, vargjet nënkuptojnë një kërkesë për mirëkuptim dhe një ftesë për të pranuar kufizimet si pjesë të natyrshme të jetës njerëzore, duke ruajtur në të njëjtën kohë magjinë e ëndrrave dhe dëshirave të mëdha.

Apo vargjet:

Njëzet metra dru të malit
Që s'mund t'i bajë shpinë e kalit
Katër qerre dërrasa të thata
E bujashka me lopata¹⁴

Në këto vargje fokusi në përmasat e mëdha të materialeve – njëzet metra dru, katër qerre dërrasa – dhe në përshkrimin e një bujashke me lopata, krijon një pamje që ngjan si një betejë epike e njeriut me ngarkesat e natyrës dhe fuqinë e tokës. Edhe këtu ironia qëndron në faktin se këto ngarkesa janë aq të mëdha, saqë edhe kali, simbol i fuqisë dhe i qëndrueshmërisë, nuk mund t'i mbajë mbi shpinë. Ky imazh sjell një humor të hollë dhe një koment për kufizimet e qenies njerëzore dhe të kafshëve përballë sfidave që ndonjëherë i tejkalojnë forcat fizike. E gjitha na lë të kuptojmë se disa gjëra në jetë janë jashtë mundësive të individit, sado i fuqishëm qoftë ai. Përtej pamjes vizuale, ato mund të kenë edhe një kuptim figurativ, ku druajtja e një ngarkese të madhe shndërrohet në një metaforë për barrën e detyrave dhe përgjegjësisë në jetën e përditshme, ku, pavarësisht dëshirës për të përballuar gjithçka, ka gjëra që na sfidojnë dhe që na bëjnë të ndiejmë se na kapërcejnë.

Poezia përfundon me këto vargje:

Por një dimër dalëngadal
N'bark e futi krejt një mal
A s'iu duket, pra çudi
Sa han stufa për t'u ngi¹⁵?

¹⁴ Vargje nga poezia “Kush e përbin malin”

¹⁵ Vargjet e fundit të poezisë “Kush e përbin malin”

Në këtë poezi, autori përdor me mjeshtëri imagjinatën dhe realen, duke i ndërthurur për të krijuar një efekt të fortë të ironisë dhe të mrekullisë së natyrës. Imagjinata vjen në fillim, kur autori përshkruan një situatë pothuajse të pabesueshme: një fëmijë që përpiket të “përbijë malin”. Ky imazh përshkruan një përpjekje të pamundur, një akt fantastik që e sfidon logjikën dhe realitetin. Përmendja e “pesë mijë kile gërdhnela druri” dhe “gjysmë vagoni thëngjill guri” e zgjeron këtë imazh, duke e bërë përmasën e sfidës aq të madhe, sa që kalon në fushën e imagjinatës dhe absurdit. Autori këtu e përçon një ndjenjë habie dhe një humor të hollë, duke luajtur me fuqinë e ëndrrës dhe imagjinatës.

Realja, nga ana tjetër, mishërohet në fund të poezisë, kur dimri, në mënyrë të ngadaltë dhe të pashmangshme, “përpin” atë mal të madh përmes nevojës njerëzore për ngrohje. Ky është një proces real, i përjetuar nga shumë njerëz gjatë dimrit, kur nxehtësia që prodhohet nga druri dhe thëngjilli bëhet një pjesë thelbësore e mbijetesës. Kjo pjesë është e përzemërt dhe e njohur, duke e vendosur lexuesin e vogël në kontakt me një të vërtetë të thjeshtë dhe të zakonshme të jetës së përditshme. Kjo ndërlidhje mes imagjinatës së madhe dhe realitetit të thjeshtë përforcon mesazhin e poezisë: edhe gjërat më kolosale përfundojnë të thjeshtësuara dhe të përfshira në ciklin e jetës, duke u konsumuar natyrshëm, pak e nga pak, nga nevoja njerëzore dhe nga koha.

Pra, në përfundimin e poezisë, shkrimtari Agim Deva përdor një kthesë të papritur për të shprehur në mënyrë ironike dhe humoristike fuqinë e natyrës për të transformuar dhe “përpirë” atë që duket e pamundur. Dimri, në mënyrë të qetë dhe të ngadalshme, arrin të “futë në bark” një mal të tërë, duke shndërruar të gjithë atë masë druri dhe thëngjilli në nxehtësi dhe jetëgjatësi përmes procesit të ngrohjes. Ky përshkrim i dhënies së një mali për ngrohjen e stufës krijon një imazh të fuqishëm të konsumimit të pashtershëm të natyrës, por njëkohësisht edhe një reflektim mbi nevojën e përhershme për mbijetesë që ka njeriu në dimër. Vargjet finale, përmes pyetjes retorike, nxisin një ndjenjë habie dhe një lloj përlësie përballë fuqisë së të natyrës dhe të kohës. Një dimër i gjatë, duke konsumuar pak e nga pak një mal të tërë, vë në dukje natyrën ciklike dhe transformuese të jetës. Në thelb, poezia kthehet në një reflektim mbi mënyrën sesi të gjitha gjërat, sado të mëdha apo të vogla, janë pjesë e një procesi të pandërprerë, ku edhe gjërat më të përmasave kolosale mund të “hanë” dhe të përfundojnë të asgjësuara në mënyrë të thjeshtë dhe të qetë.

Shembull konkret, në poezinë “Pikniku i rrugës”, Agim Deva përdor imagjinatën për të krijuar një lidhje poetike midis rrugës dhe bjeshkës, duke i personifikuar ato si dy elemente që mund të komunikojnë e të bashkëpunojnë. Rruga “bëhet gati” për t’u nisur drejt bjeshkës si një njeri që planifikon një vizitë, gjë që sjell një ndjesi të gjallë për lexuesin.

U bë rruga një ditë gati
T’i shkoj bjeshkës në vizitë
Do t’i bij tha, trup kah shpati

Ku s'kalojnë as dhentë as dhitë¹⁶

Për më tepër, rruga vendos të kalojë “trup kah shpati”, duke zgjedhur një drejtim të vështirë, ku “s'kalojnë as dhentë as dhitë”. Po të merrej si reale kjo, atëherë vargjet tregojnë jo vetëm guximin dhe vendosmërinë e rrugës, por edhe kontrastin midis botës së njeriut dhe asaj të natyrës së virgjër e të egër. Duke e paraqitur rrugën në mënyrë të tillë, Deva ndihmon lexuesin të kuptojë simbolikën e rrugëtimit të vështirë, një motiv që shpesh reflekton udhëtimin e brendshëm të individit në përpjekje për t'i kaluar kufijtë e zakonshëm. Imagjinata këtu nuk shërben thjesht për zbulim poetik, por edhe për të thelluar kuptimin e lidhjes mes njeriut dhe natyrës, duke paraqitur përpjekjen për të arritur diçka të lartë e të paarrtshme. Apo, në vargjet pasuese:

Ja pra, rruga kështu vendosi
Rrobet mirë i hekurosi
U shtri njëherë për së gjati
Veshi gzofin prej asfalti¹⁷

Siç edhe mund të shihet, në këto vargje shkrimtari Agim Deva ka ndërthurur realen dhe imagjinatën në një mënyrë të veçantë, duke përdorur imazhe nga jeta e përditshme dhe duke i shndërruar ato përmes personifikimit dhe simbolikës poetike. Reales i përket ideja e rrugës dhe asaj që ajo përfaqëson një element i ndërtuar nga njeriu, që shërben për të lidhur vende të ndryshme dhe për t'i bërë ato më të arritshme. Detaje si “gzofi prej asfalti” dhe përgatitja për “vizitën” i përkasin përvojës konkrete të krijimit të rrugëve moderne.

Imagjinata, nga ana tjetër, shfaqet në mënyrën se si rruga merr cilësi njerëzore: ajo “vendos,” “hekuros rrobat,” “shtrihet” dhe “vesh” asfaltin, duke u sjellë sikur ka jetë dhe vullnet. Ky përshkrim e largon rrugën nga aspekti i saj i zakonshëm fizik dhe e shndërron në një qenie me qëllime e karakter. Kjo lidhje e rrugës me botën e gjallë dhe simbolikën e saj i jep lexuesit ndjesinë e një rrugëtimi të brendshëm apo të një përpjekjeje njerëzore për të tejkaluar pengesa. Pra, ky kombinim i reales dhe imagjinatës i jep veprës një dimension të thellë filozofik dhe poetik, duke na kujtuar se natyra dhe jeta përreth mund të interpretohen si diçka më e gjallë dhe më dinamike se sa duket në pamje të parë. Në këtë mënyrë, Deva sjell një vizion ku realiteti dhe imagjinata bashkëveprojnë për të dhënë një kuptim krijimtarisë së tij letrare për vocërrakët.

“Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë: Udhëtimi i Agim Devës për edukimin dhe kulturën shqiptare”

¹⁶ Poezia “Pikniku i rrugës”

¹⁷ Nga e njëjta poezi

Në këtë punim nuk mund ta anashkalojmë një nga iniciativat më të rëndësishme të fillimshkullit të ri, të ndërmarrë nga shkrimtari i shquar për fëmijë, Agim Deva, pra themelimin e Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë. Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë, i themeluar nga Agim Deva, ishte një iniciativë unike në fushën e letërsisë shqipe për fëmijë dhe një projekt kulturor i rëndësishëm që synonte të afronte fëmijët me librin dhe lexuesit e vegjël me krijuesit e tyre të preferuar. Kjo nismë kulturore, e cila filloi të zhvillohej nga viti 2000 e këndej, kishte për qëllim të promovonte letërsinë shqipe për fëmijë, duke vizituar shkolla dhe qendra të ndryshme në Kosovë. Përmes këtij karvani, shkrimtarët kishin mundësinë të komunikojnin drejtpërdrejt me fëmijët, të lexonin krijimet e tyre dhe të inkurajonin lexuesit e rinj që të dashuronin librin dhe të shijonin magjinë e letërsisë. Karvani i udhëhequr nga Agim Deva, ndihmonte në formimin e kulturës letrare të brezave të rinj, duke pasur një ndikim të thellë në zhvillimin e letërsisë për fëmijë dhe në ndërtimin e një audience të re lexuesish. Agim Deva, përmes kësaj nisme, kontribuoi jo vetëm në promovimin e letërsisë për fëmijë, por edhe në lidhjen më të ngushtë ndërmjet autorëve dhe lexuesve të vegjël, duke krijuar një kulturë të leximit dhe duke i dhënë rëndësi të veçantë edukimit përmes artit letrar. Kjo iniciativë ishte një nga përpjekjet e para të Kosovës së pasluftës, që kishte për synim të promovonte librin në një kohë kur lidhja ndërmjet shkrimtarëve dhe lexuesve të vegjël ishte e kufizuar, pikërisht për shkak të situatës në të cilën ndodhej vendi. Karvani jo vetëm që shërbeu për të promovuar letërsinë për fëmijë, por përmes tij, libri dhe shkrimtari arritën të kenë një ndikim të thellë e të drejtpërdrejtë në formësimin e mendësisë së brezave të rinj. Letërsia dhe arsimi për fëmijë ishin dy aspekte kyçe në ruajtjen e gjuhës, traditës dhe shpirtit shqiptar. Deva, me vizionin e tij të qartë dhe dashurinë për fëmijët, pa tek ky karvan një mundësi për t'u mësuar brezave të rinj rëndësinë e gjuhës dhe kulturës shqiptare.

Përmes Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë, shkrimtarë të njohur dhe të talentuar udhëtonin nëpër shkolla, fshatra dhe qytete, duke kaluar nga një vend në tjetrin për të takuar fëmijët shqiptarë. Gjatë këtyre takimeve, ata lexonin poezi dhe tregime, zhvillonin biseda me fëmijët dhe i inkurajonin ata të lexonin, të shkruanin dhe të ëndërronin. Kjo nismë e bëri letërsinë për fëmijë të gjallë, të prekshme dhe të afërt me realitetin e tyre të përditshëm.

Ndikimi arsimor dhe kulturor i karvanit ishte i jashtëzakonshëm. Për shumë fëmijë, këto takime ishin eksperiencat e para me shkrimtarë dhe libra që flisnin për ndjenjat dhe përvojat e tyre. Ata u ndjenë të vlerësuar dhe të motivuar, duke e parë leximin jo si detyrim shkollor, por si një mundësi për të shprehur dhe zgjeruar botën e tyre të brendshme. Kjo qasje ndihmoi në krijimin e një brezi të ri lexuesish të cilët u rritën me një dashuri të veçantë për librin dhe kulturën shqiptare.

Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë ishte një mision edukativ por mund të quhet edhe patriotik, meqë shërbeu për të ruajtur dhe përforcuar ndjenjën kombëtare tek të rinjtë, duke i pajisur ata me vlera dhe njohuri të rrënjësura në gjuhën dhe traditën shqiptare. Përmes fjalës

së shkrimtarëve, fëmijët përjetonin një lidhje më të fortë me identitetin e tyre kulturor dhe kuptonin se letërsia mund të jetë një forcë që ruan dhe kultivon shpirtin e një populli.

Ky projekt, i drejtuar nga Deva, ndihmoi gjithashtu zhvillimin e letërsisë për fëmijë në gjuhën shqipe, duke i frymëzuar shkrimtarët të krijonin vepra të reja dhe të pasura. Duke e ndjerë nga afër ndikimin që kishin tek lexuesit e vegjël, ata motivoheshin të krijonin më shumë libra të përshtatshëm për fëmijët, duke pasuruar kështu letërsinë shqipe dhe duke e bërë atë më të qasshme për ta. Për shumë shkrimtarë të kohës, pjesëmarrja në këtë karvan ishte një përvojë e rëndësishme dhe frymëzuese që ndikoi në krijimtarinë e tyre të mëtejshme.

Karvani i Shkrimtarëve për Fëmijë mbetet një nga nismat më të rëndësishme në historinë e letërsisë shqiptare për fëmijë, një shembull i përkushtimit të Agim Devës për edukimin dhe ruajtjen e vlerave kombëtare përmes letërsisë. Ky karvan nuk ishte vetëm një udhëtim i shkrimtarëve drejt lexuesve të vegjël, por një udhëtim kulturor e shpirtëror që la gjurmë të thella tek fëmijët e kohës, duke ndikuar në rritjen e tyre si individë dhe si qytetarë të ndërgjegjshëm për vlerat e kombit të tyre.

Në përfundim, mund të përmbledhim rolin unik të Devës në letërsinë shqiptare përmes përdorimit të ndërthurjes së reales dhe imagjinatës. Kjo metodë i jep lexuesit të vogël emocione të veçantë duke e bërë shumë të këndshme dhe tejet tërheqëse poezinë e cila përmban dy botë, atë imagjinare dhe botën reale.

LITERATURA

Agim Deva Vjersha të zgjedhura për fëmijë, poezia KITRRA, fq.39. – Rilindja, 19
Agim Deva- Zonja e livadheve, 1968

Agim Deva-Fjala bëhet lule, libër leximi : për klasën IV të shkollës fillore , 1979

Astrit Bishqemi - Kumtesë e mbajtur në Prishtinë, më 6 qershor 2014, në tryezën shkencore kushtuar 5-vjetorit të vdekjes së Agim Devës

Astrit Bishqemi, Dije Demiri-Frangu, Xhahid Bushati, Sabit Jahja, Veli Velu, Dritë Ruhani, Udhëtimi krijues përmes dy linjave - SAS, Prishtinë 2021

Hysni Hoxha- “Teoria e novels dhe tregimit”,redaksia “Flaka e vllazërimit”,Shkup,1995

Johan V. Gëte-Veptra të zgjedhura-redaksia e botimeve “Rilindja”,Prishtinë, 1988

Letërsia për fëmijë (pjesa I: Teoria) - Sh.B. Sejko, Elbasan 1997

Pandeli Koçi - Nderim për shkrimtarin e mirënjohur, Agim Deva, 2009, f. 19.

Rene Wellek, Austin Warren- “Teoria e letërsisë”, shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë,

Rexhep Qosja-“Dialogje me shkrimtarët”-Rilindja,Prishtinë,1968

Osman Gashi-“Miti dhe romantizmi evropian”,PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005.

Zejnullah Rrahmani , Teoria e letërsisë, Fakulteti Filologjik, Prishtinë 1996

Grup autorësh-Letërsia bashkëkohore shqiptare, Shtëpia botuese e librit shkollor-Tiranë, 2004 Grup autorësh-Letërsia bashkëkohore shqiptare 4,Shtëpia botuese e libri shkollor-Prishtinë,2001 Grup autorësh – Letërsia botërore 2, Shtëpia botuese e librit shkollor-Prishtinë,1999

PAKICAT MYSLIMANE DHE THIRRJA ISLAME NË EVROPË: STRATEGJITË E PREDIKIMIT NË KONTEKSTIN EVROPIAN

Prof.Ass.Dr. Rexhep Suma-Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë

ABSTRACT

Në Evropë, komunitetet myslimane përbëjnë një segment të rëndësishëm të shoqërive moderne, duke u rritur nëpërmjet migrimit dhe lindshmërisë natyrore. Këto pakica përballen me sfida të ndryshme si integrimi, islamofobia dhe kufizimet ligjore mbi lirinë fetare. Një aspekt kritik i jetës myslimane në Evropë është thirrja islame (da'ëa), e cila kërkon përshtatje strategjike për t'u zhvilluar në një ambient sekular dhe shpesh skeptik ndaj fesë. Ky punim analizon strategjitë e predikimit të Islamit në Evropë, sfidat e përhapjes së mesazhit islam dhe mënyrat më efektive për të komunikuar me audiencën evropiane. Islami, nga ana tjetër, është një forcë e jashtëzakonshme shpirtërore në kërkim të formave moderne. Historikisht, Islami merret me ndërtimin e një qytetërimi të shquar botëror, në të cilin shkenca dhe feja, laikja dhe fetarja punonin në harmoni për të përparuar jetën njerëzore. A mundet Islami të luajë një rol të ngjashëm për rivendosjen e thelbit moral në jetën moderne dhe në arrestimin e prirjeve gjithnjë e më të pamoralshme dhe irracionale të botës postmoderne?!

Fjalë kyçe: pakica islame, identitet kombëtar, dava, tolerance fetare, Evropë.

1.1. Hyrje

Prezenca e myslimanëve ka qenë një faktor konstant në historinë evropiane qysh nga shek. VII e.r., pas paraqitjes së Islamit. Myslimanët kanë qenë tregtarë, ndaj edhe da'ij (misionarë) anëmbanë botës. Brenda disa dekadave nga vdekja e Muhamedit a.s. (632), ndjekësit e tij i tejkaluan kufijtë e Arabisë dhe u futën në Persi dhe Bizant, që ishin dy perandori të cilat e kishin ndarë më dysh Lindjen e Mesme dhe të cilat kishin futur nën kontrollin e tyre hapësira e territore të gjera. Në Evropë, myslimanët vijnë përmes Spanjës (711 e.r. / 94 h.) dhe Sicilisë (831 e.r. / 215 h.) dhe më vonë përmes Ballkanit (shek. XI e këtej).¹⁸Qysh atëherë bashkësitë myslimane kanë jetuar në pjesë të ndryshme të Evropës. Kanë kaluar periudha të gjata të sundimit mysliman në Spanjë (Andaluzi), Sicili dhe Ballkan, si dhe qendra të veçuara autonome të myslimanëve në Francë, Zvicër, Gjermani dhe Italinë Jugore.

¹⁸ Më shumë shiko Khurshid Ahmedit, Muslims in Europe, të paraqitur në The Islamic Council of Europe, prill, 1976, të botuar nga The Islamic Foundation, Leicester, UK.

Një qasje shkencore për studimin e pakicave myslimane në Evropë përfshin analiza të thelluara që adresojnë disa aspekte të rëndësishme, si identiteti fetar, integrimi shoqëror, sfidat e integritit, dhe ndjeshmëria kulturore dhe politike që lidhen me këto grupe. Kjo mund të bëhet përmes disa qasjeve dhe metodologjive të ndryshme. Ndërsa Krishterimi dhe Islami kanë qenë pas shumicës së arritjeve njerëzore, është gjithashtu për shkak të shtrembërimit të këtyre dy besimeve që ne kemi hasur dhe jemi ende duke u përballur me problemet e jashtëzakonshme të proporcioneve globale. Krishterimi me mesazhin e tij të paqes dhe tolerancës u shtrembërua aq shumë, sa që justifikonte imperializmin e pamëshirshëm dhe padrejtësitë nëpër kolonitë e tij në Azi, Afrikë dhe Amerikën Latine. Në të vërtetë, ishte një shtrembërim i asaj feje të madhe dhe shpirtit të saj. Ai gjithashtu lindi nacionalizmin, ku qeniet njerëzore theksuan vetëm dallimet që i shërbenin lehtësisht oportunistëve si bazë për urrejtje e luftëra. Propaganda e tij gjithashtu kontribuoi në shtrembërimin e Islamit dhe të myslimaneve. Islami e ngriti qytetërimin njerëzor nga Mesjeta e Errët në lartësitë e reja dhe krijoi një qytetërim të ri, me anë të shkencave të avancuara empirike dhe eksperimentale, si dhe rriti ndërgjegjësimin për nevojën e unitetit njerëzor, bazuar në konceptin e monogjenezës¹⁹.

Sociologët studiojnë si myslimanët në Evropë janë integruar në shoqëritë përkatëse, duke u fokusuar në ndërveprimin e tyre me shoqërinë pritëse, duke shqyrtuar aspekte të tilla si arsimimi, punësimi, dhe përfshirja politike. Kjo qasje analizon gjithashtu sfidat që ata përballen, si diskriminimi, marginalizimi dhe ngjarjet e islamofobisë që mund të ndikojnë në procesin e integritit. Nga aspekti i antropologëve analizojnë identitetin kulturor të myslimanëve në Evropë, dhe si ai ndërvepron me kulturat vendase. Ky studim ndihmon në kuptimin e ndryshimeve dhe ngjashmërisë mes komunitetit mysliman dhe popullsisë më të gjerë, duke studiuar praktikën fetare, vlerat, dhe traditat që formojnë jetesën e përditshme të myslimanëve. Qasjet historike mund të shqyrtojnë migrimin e grupeve myslimane në Evropë, duke përfshirë periudhat e kolonializmit dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo qasje mund të analizohet përmes teorive të migracionit, duke shqyrtuar politikat e integritit dhe ndryshimet në politikat e emigracionit dhe azilit që kanë pasuar. Kurse nga aspekti i politologëve mund të shqyrtojnë politikat e shteteve evropiane për sa i përket të drejtave të pakicave myslimane. Kjo përfshin politikat e tolerancës fetare, ligjet për lirinë e fesë, dhe reagimet ndaj ekstremizmit. Për më tepër, studimi i lëvizjeve të islamofobisë dhe mënyrave se si këto fenomene ndikojnë në jetën e myslimanëve në Evropë është një aspekt kyç i këtij hulumtimi. Grupet myslimane kontribuojnë në ekonominë evropiane dhe se si ata përballen me pabarazi të mundshme në sektorë të ndryshëm, përfshirë punësimin dhe shpërndarjen e pasurisë. Ky studim mund të shqyrtojë gjithashtu të drejtat ekonomike të pakicave dhe ndikimin e krizave ekonomike në këto grupe.

¹⁹ Al-Faruqi, Ismail R, al-Tawhid: Its Implications for Thought and Life (Herndon, VA: The International Institute of Islamic Thought, 1992), f. 78–79

Për të sjellë paqe të sinqertë në këtë fshat global, ne duhet të ringjallim pastërtinë e pacenuar dhe frymën e barazisë monoteiste dhe të drejtësisë për të gjithë. Duhet të sigurohemi që këto vlera shpirtërore të kthehen në fuqi për t'i sjellë njerëzit në kuptimet e tyre. Megjithëse Kombet e Bashkuara deklaruan se lufta ishte e paligjshme, kishte më shumë luftëra në botë midis viteve 1950 dhe 2000, sesa kurrë më parë. Pra, nuk janë thjesht fjalët, por edhe fryma që i bashkon njerëzit të vlerësojnë njëri-tjetrin. E gjithë ideja e Islamit, dhe më parë e Krishterimit, është të sjellin njerëzit në këtë mesazh universal shpirtëror, për t'i bërë ata të identifikohen me njëri-tjetrin, si krijime të Zotit të Vetëm (SËT)¹¹ për të shërbyer për kauzën e mirë në këtë botë dhe për të arritur lumturinë e përhershme në botën e përtejme.²⁰

1.2 Objektivat e Punimit Ky studim synon të:

1. Identifikojë sfidat kryesore me të cilat përballen myslimanët në përhapjen e thirrjes islame në Evropë.
2. Vlerësojë efektivitetin e strategjive të ndryshme të predikimit.
3. Propozojë metoda të reja për një qasje më të suksesshme të da'ëas në Evropë.

1.3 Metodologjia

Ky punim bazohet në një qasje analitike dhe krahasuese, duke përdorur të dhëna nga studime akademike, raportet e organizatave myslimane dhe dokumente qeveritare mbi lirinë fetare. Analiza do të fokusohet në vende të ndryshme evropiane me një prezencë të konsiderueshme myslimane si Franca, Gjermania dhe Britania e Madhe etj.

Pyetjet kërkimore

1. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen pakicat myslimane në Evropë në përhapjen e thirrjes islame?
2. Cilët faktorë ndikojnë në efektivitetin e strategjive të predikimit në kontekstin evropian?
3. Si mund të përshtatet thirrja islame me realitetin kulturor, politik dhe social të Evropës?

Hipotezat

²⁰ Ataullah Siddiqui (ed.), Ismail Raji al-Faruqi, Islam and Other Faiths (Leicester, UK: Islamic Foundation, 1998), f. 28, 146, 153.

1. Islamofobia dhe kufizimet ligjore përbëjnë pengesat kryesore për predikimin islam në Evropë.
2. Përdorimi i mediave sociale dhe dialogu ndërfaqetor rrisin efektivitetin e thirrjes islame.
3. Integrimi i të rinjve dhe krijimi i qendrave kulturore islame ndikon pozitivisht në përhapjen e mesazhit islam.

1.4 Sfidat e Thirrjes Islame në Evropë

Myslimanët në Evropë përballen me sfida të shumta në përhapjen e mesazhit të tyre fetar. Këto përfshijnë:

- *Islamofobia dhe stereotipet negative:* Shumë media dhe grupe politike paraqesin Islamin në një dritë negative, duke e bërë më të vështirë predikimin e tij.
- *Kufizimet ligjore:* Në disa vende evropiane, ekzistojnë kufizime mbi ndërtimin e xhamive, përdorimin e veshjeve islame dhe organizimin e aktiviteteve fetare publike.
- *Mungesa e unitetit mes komuniteteve myslimane:* Ndryshimet etnike dhe sektare brenda komunitetit mysliman shpesh pengojnë një qasje të unifikuar në da'ëa.

1.5 Strategjitë efektive të predikimit

Strategjitë e predikimit në kontekstin evropian përfshijnë një qasje të balancuar mes traditës dhe modernitetit. Këto strategji shpesh përfshijnë përdorimin e medias, si dhe platformave digjitale për të shpërndarë mesazhe të besimit. Predikuesit evropianë shfrytëzojnë gjithashtu hapsira publike dhe aktivitete komunitare për të rritur ndërgjegjësimin për vlerat fetare, duke iu përshtatur gjithmonë konteksteve kulturore dhe shoqërore të ndryshme. Pjesëmarrja në dialogë interreligjioz dhe promovimi i një të kuptuari të përbashkët janë gjithashtu aspekte kyçe të këtyre strategjive. Për të përballuar këto sfida, janë zhvilluar disa strategji të suksesshme:

1. *Përdorimi i mediave sociale:* Platforma si YouTube, Facebook dhe TikTok janë bërë mjete të fuqishme për të përhapur mesazhin islam te një audiencë më e gjerë.
2. *Dialogu ndërfaqetor:* Bashkëpunimi me komunitete të tjera fetare ndihmon në uljen e paragjykimëve dhe promovimin e një imazhi pozitiv të Islamit.

3. *Përfshirja e të rinjve*: Edukimi islam modern dhe i përshtatur me realitetin evropian është thelbësor për ruajtjen e identitetit islam mes brezave të rinj.
4. *Institucionet islame dhe qendrat kulturore*: Xhamitë dhe institucionet islame kanë një rol kyç në organizimin e aktiviteteve edukative dhe shpirtërore.

Në një kontest të tillë, predikimi në Evropë kërkon gjithashtu një vëmendje të veçantë ndaj ndjeshmërive kulturore dhe ligjore, sidomos për shkak të legjislacionit të rreptë në lidhje me lirinë e fesë dhe ndalimin e diskriminimit. Kjo do të thotë se strategjitë e predikimit duhet të jenë të kujdesshme për të siguruar që mesazhet e besimit të respektojnë vlerat e shoqërisë evropiane, duke e mbajtur gjithashtu besimin e tyre të pasur dhe autentik.

1.6 Vlerat islame diversiteti kulturor dhe ai ndërfaqësor

Nocioni *Islam* ka të njëjtën prejardhje në gjuhën Arabe me fjalët *nënshtrim*, *shpëtim* dhe *paqe*. Islami është fe për sigurinë, qetësinë dhe paqen. Islami është më shumë se një sistem i etikës, i ritualeve, i teologjisë dhe reformës sociale. Është një qytetërim i plotë. H.A.R. Gibb në librin e tij “*Ku është Islami*” thekson: “Islami i pajis njerëzit e tij me një dinjitet të veçantë. Lidhja e drejtpërdrejtë me Perëndinë është tërheqja më e fortë e Islamit. Myslimani me gjithë ndjenjën e epërsisë së tij nuk e ka kompleksin e garës. Etika dhe koncepti i Islamit për moralin shoqëror dhe personal është pafundësisht më e lartë, pafundësisht më e përsosur se konceptimi përkatës brenda civilizimit perëndimor. Islami e ka ndaluar urrejtjen dhe ka hapur rrugën për vëllazërinë njerëzore dhe barazinë, por qytetërimi perëndimor ende nuk është në gjendje të shikojë përtej horizontit të ngushtë të antagonizmit racor dhe kombëtar. Feja Islame kurrë nuk ka njohur klasa dhe luftë klasore brenda shoqërisë së saj, por e gjithë historia evropiane që nga koha e Greqisë dhe Romës është plot me luftë klasore dhe urrejtje sociale. Islami është me të vërtetë shumë më tepër se një sistem i teologjisë, është një qytetërim i plotë.”²¹

Kultura dhe civilizimi i manifestuar nga mësimet e Islamit janë bërë një model për njerëzimin, siç shpjegohet nga Robert Briffault në *The Making of Humanity*: “Idealet e lirisë për të gjitha qeniet njerëzore; për vëllazërinë njerëzore, për barazinë e njerëzve përpara ligjit të qeverisjes demokratike, me anë të votës universale, idealet që frymëzuan Revolucionin Francez dhe Deklaratën për të Drejtat e Njeriut, që udhëhoqën inkuadrimin e Kushtetutës Amerikane, dhe që ka ndezur luftën për pavarësi në vendet e Amerikës Latine, nuk ishin shpikje të Perëndimit. Ata frymëzimin dhe burimin e gjejnë në Kur’an.

²¹ Abidin, Danial Zainal, *Islam the misunderstood Religion*, (Kuala Lumpur: PTS Millennia Sdn, 2007) f. 37

Ato shpikje janë kuintesenca e asaj që inteligjenca e Evropës mesjetare ka kërkuar nga Islami gjatë një periudhe shekullore përmes shoqërive të ndryshme që u zhvilluan në Evropë pas Kryqëzatave, të cilat ishin imitim i shoqatave të vëllazërimit Islam.”²²

Feja e Islamit është themeluar pesëmbëdhjetë shekuj më parë, me shpalljen e Kur’anit Muhamed a.s.. Së pari dhe më kryesorja, Islami përbëhet nga një besim në Zot (iman) dhe është një thirrje për të kultivuar përsosmërinë morale (*ihsan*) në qëndrimet dhe veprimet e dikujt. Është një vizion gjithëpërfshirës për të udhëhequr një jetë të mirë, e cila thekson vlerat shpirtërore dhe morale, detyrimin shoqëror ndaj të tjerëve dhe përgjegjësinë individuale.²³ Termi “Islam” përshkruan një qëndrim universal fetar. Islami kërkon të na bashkojë me fushën e madhe të qenies dhe përpiqet të krijojë një unitet absolut midis nesh dhe universit. Ne jemi partneri më thelbësor në Mbretërinë e Ekzistencës dhe myslimani është bashkëfetar i të gjitha krijesave.²⁴ Kur’ani pranon ekzistencën e feve të ndryshme dhe vendos çdo lloj diversiteti në të gjitha format e saj. Doktrina islame e pluralizmit rrjedh nga një parim logjik: Sepse në Islam vetëm Zoti është Unik dhe Një, të gjithë të tjerët, përveç Tij, pra i gjithë krijimi është projektuar në shumëllojshmëri ose diversitet.

Ngjyrat, racat, fetë dhe dallimet e tjera nuk janë pengesë për bashkëjetesë, përkundrazi ato në Islam pranohen si pasuri dhe si vullnet hyjnor. Nuk duhet harruar një fakt tejet i rëndësishëm: Kur’ani është shkrimi i vetëm që krijon universalizmin e shpalljes hyjnore dhe diversitetin ndërfaqet. Të jesh mysliman nënkupton njohjen e autenticitetit të të gjitha feve të shpallura para Islamit. Për më tepër, pranimi i feve të tjera përbën një ndër shtyllat kryesore të besimit Islam, që do të thotë; mospranimi i tyre si të tilla (pavarësisht ndryshimeve që mund të kenë pësuar gjatë historisë) shkakton daljen nga feja. Në praktikë, Myslimani duhet t’i trajtojë individët jomyslimanë si të barabartë në fushën e ndërveprimit social, pavarësisht nga mosmarrëveshjet fetare ose doktrino.²⁵

“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t’i bashkonte në një bashkësi të vetme (por nuk dëshiroi, Ai e di arsyen).”²⁶

Islami nuk mohon se ka ngjyra të ndryshme ose gjuhë të ndryshme, megjithatë ky nuk është një shkak për përcaktimin e superioritetit ose inferioritetit të individëve dhe grupeve. Kjo do të thotë t’i sjellësh njerëzimit mrekullitë e Zotit në krijim. Pra, ky është një fenomen pozitiv. Sipas Islamit dhe Krishterimit, drejtësia dhe

²² Po aty, f. 38.

²³ El-Affendi, Abdelwahab A. (Co-author), *Contextualising Islam in Britain: exploratory perspectives*, (HRH Prince Alwaleed Bin Talal Center of Islamic Studies: Cambridge University) f. 15.

²⁴ Uyukcelebi, Ismail, *Living in the Shade of Islam*, (New Jersey: The Light, 2005), f. 1

²⁵ El-Affendi, *Contextualising Islam in Britain: exploratory perspectives*, f. 12

²⁶ Kur’an 11: 118.

përgjegjësia personale janë qendrore.¹³ Ne duhet gjithmonë të bëjmë drejtësi për të gjithë, madje edhe për armiqtë tanë. Ajo që solli Islami, ishte liria fetare. Kurdoherë që ka pasur një luftë për hir të Islamit, ishte vetëm për t'i sjellë njerëzve lirinë e tyre. Kushdo që pajtohet me këtë, ndan qëllimin e paqes. Kushdo që u mohon qenieve njerëzore lirinë e bindjes dhe fesë së vet, nuk duhet të lejohet ta bëjë këtë.

“Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë.”²⁷

Porosit kur'anore kanë shprehur qartë qëndrimin paqësor dhe tolerant si dhe respektin ndaj jomyslimanëve: **“Thuaj: ‘O ju mosbesimtarë! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuronit dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuronit dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj! Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!’”²⁸**

1.7 Rruajtja e identitetit kombëtar në hijën e kontekstit evropian

Dialogu ndërfaqësor e ndërkulturor, vetëm kontribuon drejt mirëkuptimit të faktit se pavarësisht veçantive tona, ndajmë vlera pozitive dhe ballafaqohemi me sfida të ngjashme. Para fundit të Dekadës së KB-së për dialog midis civilizimeve, dhe Dekadës për kulturën e paqes, në kushte kur procesi i globalizmit gjithsesi se na bashkon, me rëndësi esenciale është që të mos lejojmë që religjioni dhe kultura të shndërrohen në forca që çojnë drejt konflikteve dhe ndarjeve. Megjithatë, shoqëria e sotme shqiptare, sikurse edhe në periudha të tjera të evoluimit të brendshëm të saj, krahas unitetit shpirtëror të formuar përgjatë historisë, shpreh edhe një larmi të pasur nënkulturash, domethënë nuancime identiteti kulturor, dallime të spikatura brenda të njëjtit identitet kulturor kombëtar.²⁹

Meqë burimet ekonomike, teknologjike dhe financiare nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë rreth botës, disa grupe etnike, kulturore dhe kombëtare përballen, me më shumë vështirësi në ruajtjen e identiteteve dhe traditave të tyre. Për rrjedhojë, për të kuptuar problemet rreth imperializmit kulturor, është e rëndësishme të analizojmë ndikimin e kulturës popullore amerikane. Nuk ka mënyra të lehta për të marrë ndikimin e kulturës popullore, por duhet të jemi në

²⁷ Kur'an 30: 22.

²⁸ Kur'an 109: 1-6

²⁹ Fuga, A. & Dervishi, Z.(2010), Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global, Dudaj, Tiranë, f.219.

ndjeshëm ndaj ndikimeve të saj në komunikimin ndërkulturorë. Shumë grupe kulturore përreth botës shqetësohen rreth ndikimit të imperializmit kulturor. Qeveria e Kebekut, për shembull, është e shqetësuar për efektet e medieve në gjuhën angleze mbi gjuhën dhe kulturën franko-kanadeze. Francezët kanë shprehur gjithashtu shqetësim rreth dominimit të kulturës popullore të SHBA-së dhe ndikimit të saj në shoqërinë franceze. Imazhet e prodhuara nga industritë e kulturës siç janë filmi dhe televizioni na mundësojnë “udhëtimin” në shumë vende të botës. Kultura popullore gjithashtu na ndihmon të mësojmë rreth grupeve të tjera kulturore.

Ne priremi të mbështetemi më fuqimisht në imazhet e medias të grupeve kulturore për të cilat kemi pak apo pothuajse aspak përvojë personale, por në këtë rast stereotipizimi mund të përbëjë një problem. Një pjesë e madhe kulturës popullore prodhohet në SHBA dhe qarkullon në të gjithë globin. Mungesa e ekuilibrit të shkëmbimit midis kulturës popullore amerikane dhe teksteve të tjera të kulturës popullore, ka ngritur shqetësime rreth imperializmit kulturorë.³⁰

Në epoka të shkuara, Eco, vërtetoi se çdo komunikim i drejtohej një marrësi të përcaktuar mirë, kodet interpretuese të të cilit përkonin me ato të dërguesit. Çdo keqkuptim karakterizohej si “dekodifikim rravgues”, që rrallë përjashtonte rregullat kulturore të pranuar nga të gjithë. Ndërsa në shoqërinë e masave, ku publiku është me përkufizim i vagullt dhe i diferencuar, dekodifikimi rravgues bëhet normë. Lind, kështu, nevoja e një studimi semiologjik, që të kontrollojë flukset e komunikimit dhe që të pajiset me mjetet e nevojshme të analizës, për të kuptuar procedurat e dekodifikimit rravgues (dhe , po të doni, edhe për shmangur shfaqjen e saj në të ardhmen). Kjo parakupton, duke e krahasuar me çdo hetim sociologjik apo vlerësim estetik, analizën e strukturave komunikuese që TV-ja vë në jetë, pra të kodeve paraprake të dërguesit, të formës që ka marrë mesazhi dhe kodeve të përdorura nga marrësi.³¹

1.8 Margjinalizimi, diskriminimi dhe geteoizimi social

Në këtë vazhdë mbetet me rëndësi fakti se raportet zyrtare konfirmojnë se të rinjët myslimanë ndihen të lënë anash nga integrimet sociale dhe institucionale. Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) publikoi një raport interesant për përvojat e rinisë myslimane dhe

³⁰ Martin, J. & Nakayam, Th.(2010), *Hyrje në komunikim ndërkulturor*, përkthyer nga Elena Bozheku, UET Press, Tiranë, f.229- 231

³¹Marrone, G.(2008), *Corpi sociali, Trupat shoqërorë proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit*, përkthyer nga Dhurata Shehri dhe Persida Asllani, shtypur Guttenberg, Tiranë, f.74.

jomyslimane (12-18 vjeç) në Francë, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me përvojat e marginalizimit social dhe racizmit në lidhje me një ndjenjë të izolimit social dhe mbështetjen për përfshirjen në dhunë. Rezultati është i mprehtë për kuptimin e radikalizimit të myslimanëve të rinj në Evropë: “Në të tre vendet anëtare të BE-së të anketuara, të rinjtë që ndiheshin të marginalizuar social dhe ata që kishin qenë viktimë e dhunës për shkak të prejardhjes së tyre kulturore ose fetare, ngjyrës së lëkurës ose gjuhës, kishin më shumë gjasa të përdorin dhunën emocionale (si ngacmimi) ndaj të tjerëve sesa të rinjtë të cilët nuk ndiheshin të marginalizuar në mënyrë sociale ose ata që nuk ishin viktimizuar për arsyet e lartpërmendura. Të rinjtë myslimanë kishin nivele më të mëdha shqetësuese për tolerancën ndaj identiteteve kulturore, si në nivel personal dhe global, që ka të ngjarë të ndikojë në kuptimin e tyre mbi mënyrën në të cilën çështjet e tilla trajtohen politikisht. Duke pasur parasysh këtë, rezultatet treguan se myslimanët e rinj duket se ndihen më të pafuqishëm për të marrë pjesë në forma legjitime të protestës apo qytetarisë aktive sesa jomyslimanët e rinj. (...) Veprat e padrejtësisë ose përjashtimit ndaj të rinjve myslimanë në veçanti, mund të shkaktojnë tjetërsim nga shoqëria më e gjerë. Kjo mund t’i nxisë disa të rinj të zhvillojnë simpati ose tregojnë tendencë për përdorimin e dhunës.”³²

Procesi i integritimit kulturor në Evropë nën banderolën e ekstremizmit laik ka krijuar përjashtimin social dhe marginalizimin e myslimanëve në Evropë, e cila është e lidhur padyshim me krizat e identitetit. Marranci e ka argumentuar kështu këtë problematikë: “Gjithsesi, emigrantët myslimanë duhet të durojnë një gjuhë dhe sjellje politike skizofrenike. Nga njëra anë, Evropa u kërkon atyre të bëhen pjesë e saj, me fjalë të tjera për t’u bërë, nëse jo ‘plotësisht’ evropianë, të paktën myslimanë të Evropës; me fjalë të tjera, myslimanët që ri-përpunojnë identitetin e tyre kulturor dhe fetar për t’u bërë qytetarë të një Evrope të re, e cila përfshin edhe Islamin. Por, në të njëjtën kohë, Evropa vepron në një mënyrë që myslimanët mund të mbeten thjesht myslimanë në Evropë; me fjalë të tjera, të huaj në një mjedis evropian kristocentrik ku vetëm atij mund t’i sigurohet toleranca. Është islamofobia dhe sidomos çfarë mund të quhet islamofobia institucionale që i pengon myslimanët të bëhen të Evropës.”³³

³² Senocak, Naciye Selin *Cultural Integration of Muslims in Europe: Prevention of Cultural Misunderstanding and Radicalism*, f. 12.

³³ Marranci, Gabriele, *Multiculturalism, Islam and the Clash of Civilisations Theory: Rethinking Islamophobia*, (Culture and Religion, 5, 1, 2004) p. 110.

Anketa e Eurobarometrit e publikuar më 2009 tregon se diskriminimi i bazuar në fe është një sfidë e rëndësishme për vendet anëtare të BE: “Diskriminimi në bazë të besimit fetar shihet si më i përhapur në Holandë (59%) dhe Francë (58%), pasuar nga Danimarka (55%), Belgjika (54%), Suedia (53%) dhe Greqia (51%). Vërehet se këto janë të gjitha vendet ku çështjet e emigracionit paraqiten dukshëm në debatin publik. Në anën tjetër, vetëm 12% e çekëve dhe sllovakëve, 13% e letonezëve dhe 14% e lituanezëve mendojnë se ky lloj i diskriminimit është i zakonshëm në vendin e tyre. Këto janë të gjitha vendet ku ka shumë pak diversitet fetar.”³⁴

Përfundimi dhe Rekomandime

Thirrja islame në Evropë përballlet me sfida të konsiderueshme, por me qasje strategjike dhe inovative, mund të arrihet një përhapje më efektive e mesazhit islam. Myslimanët evropianë duhet të fokusohen në promovimin e një Islami të hapur dhe bashkëpunues, duke përdorur teknologjinë moderne dhe qasjen ndërfaqetare. Rekomandimet për një qasje më efektive përfshijnë:

- Rritjen e pranisë në mediat sociale për të arritur audiencë të reja.
- Zhvillimin e programeve edukative që promovojnë mirëkuptimin dhe respektin ndërfaqetare.
- Krijimin e qendrave islame që ofrojnë shërbime për komunitetin e gjerë, jo vetëm për myslimanët.

Në këtë mënyrë, da'wa mund të bëhet më e përshtatshme për kontekstin evropian dhe të ndihmojë në ruajtjen e identitetit islam në një ambient gjithnjë e më sekular.

Bibliography

1. Abidin, Danial Zainal, *Islam the misunderstood Religion*, (Kuala Lumpur: PTS Millennia Sdn, 2007)
2. Al-Faruqi, Isma'il R., *al-Tawhid: Its Implications for Thought and Life* (Herndon, VA: The International Institute of Islamic Thought, 1992)
3. Ataulloh Siddiqui (ed.), Ismail Raji al-Faruqi, *Islam and Other Faiths* (Leicester, UK: Islamic Foundation, 1998).
4. Bleich, Erik. *Defending the Faith: A Critique of the Fear on Terrorism*. Oxford University Press, 2009.
5. Cesari, Jocelyne. *Muslim Minorities in Europe: The Challenge of Integration*. Oxford University Press, 2011.

³⁴ European Commission (2009), Special Eurobarometer 317, *Discrimination in the European Union: perceptions, experiences and attitudes: Discrimination on the basis of religion and belief*, p. 99.

6. El-Affendi, Abdelëahab A. (Co-author), *Contextualising Islam in Britain: exploratory perspectives*, (HRH Prince Alëaleed Bin Talal Center of Islamic Studies: Cambridge University).
7. El-Affendi, *Contextualising Islam in Britain: exploratory perspectives*
8. European Commission (2009), Special Eurobarometer 317, *Discrimination in the European Union: perceptions, experiences and attitudes: Discrimination on the basis of religion and belief*.
9. Fuga, A. & Dervishi, Z.(2010), Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global, Dudaj, Tiranë.
10. Halafoff, Anna. *The Role of Muslim Minorities in European Politics*. Cambridge University Press, 2017.
11. Kaya, Ayhan. *Islam, Migration, and Integration: The Age of Securitization*. Palgrave Macmillan, 2018.
12. Khurshid Ahmedit, Muslims in Europe, të paraqitur në The Islamic Council of Europe, prill, 1976, të botuar nga The Islamic Foundation, Leicester, UK.
13. Koopmans, Ruud, and Statham, Paul. *The Integration of Immigrant Communities in Europe: National and European Perspectives*. Routledge, 2002.
14. Marranci, Gabriele, *Multiculturalism, Islam and the Clash of Civilisations Theory: Rethinking Islamophobia*, (Culture and Religion,5 ,1 ,2004)
15. Marrone, G.(2008), Corpi sociali, *Trupat shoqërorë proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit*, përkthyer nga Dhurata Shehri dhe Persida Asllani, shtypur Guttenberg, Tiranë.
16. Martin, J. & Nakayam, Th.(2010), *Hyrje në komunikim ndëlkulturor*, përkthyer nga Elena Bozheku, UET Press, Tiranë
17. Modood, Tariq. *Multiculturalism: A Civic Idea*. Polity Press, 2007.
18. Senocak, *Cultural Integration of Muslims in Europe: Prevention of Cultural Misunderstanding and Radicalism*.
19. Uyükcelebi, Ismail, *Living in the Shade of Islam*, (New Jersey: The Light, 2005)

NDIKIMI I ANGLICIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE: SHKAQET, PASOJAT DHE ROLI I GLOBALIZIMIT NË EVOLUIMIN E GJUHËS

Luljeta Avdiu Cura-Shkolla fillore,,Bedri Elezaga,,Vlladimir

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin e anglicizmave në gjuhën shqipe dhe rolin që ata luajnë në procesin e evolucionit të gjuhës në një kontekst globalizimi. Anglicizmat janë përhapur në shumë fusha të jetës, duke ndikuar drejtpërdrejt në pasurimin dhe transformimin e gjuhës shqipe. Ky ndikim është i dukshëm veçanërisht në fushat e teknologjisë, medias, biznesit dhe arsimit. Megjithatë, përhapja e anglicizmave ka shkaktuar gjithashtu shqetësime në lidhje me ruajtjen e pastërtisë gjuhësore dhe identitetin kulturor të gjuhës shqipe. Punimi diskuton arsyet që qëndrojnë pas këtij fenomeni, duke përfshirë globalizimin, ndikimet ekonomike dhe teknologjike, si dhe ndryshimet shoqërore. Po ashtu, shqyrtohen pasojat e mundshme të përdorimit të tepërt të anglicizmave, përfshirë humbjen e ndihmës së fjalëve tradicionale dhe të pasurive gjuhësore të gjuhës shqipe. Në përfundim, punimi propozon mënyra për të balancuar përdorimin e anglicizmave me ruajtjen e veçorive të gjuhës shqipe, duke theksuar nevojën për një përdorim të vetëdijshëm dhe të matur të këtyre fjalëve.

Çfarë është një anglicizëm?

Është shumë e rëndësishme të shpjegohet çfarë është një anglicizëm. Anglicizmat janë fjalë të huazuara nga anglishtja si rezultat i kontaktit të gjuhëve. Sipas Rajend Mesthrie (1995: 4) "[...është çdo strukturë që ekziston në një formë të caktuar, si rezultat i kontaktit me anglishten".

Burimi në internet [en.wikipedia.org/wiki/Anglicism], ofron përkufizimin e mëposhtëm:

Një anglicizëm është një fjalë e huazuar nga anglishtja në një gjuhë tjetër, por që konsiderohet nga një pjesë e konsiderueshme e folësve të ndikueshëm të gjuhës marrëse si nënstandard ose e padëshirueshme, ndërkohë që në rrethana të tjera, i njëjti anglicizëm mund të konsiderohet si i pasur. Anglicizmi gjithashtu përshkruan sintaksën, gramatikën, kuptimin dhe strukturën e anglishtes të përdorura në një gjuhë tjetër me shkallë të ndryshme të keqinterpretimeve.

Pra, një anglicizëm nuk është vetëm një fjalë e huazuar nga anglishtja, por gjithashtu një strukturë e përdorur abuzivisht në një gjuhë tjetër.

Gjuha përdoret nga njerëzit për të shprehur ndjenjat e tyre më të thella—për t'u lutur, për të sharë, për të bërë dashuri dhe për të komunikuar me të tjerët. Gjuha është mjeti i artikullimit të vlerave, besimeve, paragjykimeve, traditave dhe arritjeve të kaluara. Ajo është karakteristika dalluese e njeriut; është në zemër të kulturës së njerëzve; ajo është ajo që bën që njerëzit të shohin veten e tyre si të ndryshëm. Përdoret kur njerëzit vijnë në kontakt me njëri-tjetrin.

Folësit e gjuhëve ose varianteve të ndryshme vijnë në kontakt shoqëror. Një gjuhë mund të ndikojë në një tjetër në një mënyrë të përhershme. Sipas Mesthrie (1995: 7) "...kontakti i gjuhëve mund të ketë rezultatet e mëposhtme: diglosia, dygjuhësia, ndërimi i kodeve dhe huazimi i fjalëve". Elementët e parë të huaj që hyjnë në gjuhën huazuese, kur ndodh kontakti i gjuhëve, janë fjalët. Karakteristikat strukturore mund të huazohen gjithashtu, megjithatë, ajo që është më e dukshme kur njerëzit vijnë në kontakt është ndërhyrja e fjalëve.

Çfarë është gjuha globale?

Një gjuhë arrin statusin e vërtetë global kur zhvillon një rol të veçantë që njihet në çdo shtet. Kjo mund të duket si diçka e dukshme, por nuk është, sepse nocioni i "rolit të veçantë" ka shumë aspekte. Ky rol do të jetë më i dukshëm në vendet ku një numër i madh i njerëzve e flasin gjuhën si gjuhë amtare. (David Crystal-English as a global language)

Një gjuhë bëhet globale jo për shkak të numrit të folësve të saj, por për shkak të fuqisë dhe ndikimit të folësve të saj. Historikisht, latinishtja u bë një gjuhë ndërkombëtare jo për shkak të numrit të romakëve, por për shkak të fuqisë politike dhe ushtarake të Perandorisë Romake. Po ashtu, gjuhë si greqishtja, latinishtja, arabishtja, spanjishtja dhe frëngjishtja u bënë globale për shkak të dominimit politik dhe ushtarak të civilizimeve që i flisnin ato.

Përhapja e një gjuhe është ngushtë e lidhur me fuqinë e popujve të saj, veçanërisht fuqinë e tyre politike, ushtarake dhe ekonomike. Ndërsa fuqia ushtarake është shpesh vendimtare për përhapjen e një gjuhe në fillim, fuqia ekonomike është thelbësore për dominimin e saj afatgjatë. Për shembull, imperializmi britanik e përhapti gjuhën angleze globalisht gjatë shekullit të 19-të, dhe dominimi ekonomik i Shteteve të Bashkuara në shekullin e 20-të e konsolidoi më tej anglishten si gjuhën dominuese të botës.

Edhe pse disa pretendojnë se disa gjuhë, përfshirë anglishten, janë më "logjike" ose më të lehta për t'u mësuar, arsyeja e vërtetë e statusit të tyre global qëndron në fuqinë ekonomike, politike dhe teknologjike që ata që i flasin kanë. Anglishtja, konkretisht, ka përfutur nga fakti që ishte në "vendin e duhur në kohën e duhur", me rritjen ekonomike të Britanisë dhe më pas të SHBA-së, përkrah përpertimeve në komunikim global që e forcuan ndikimin e saj (Crystal, 2003).

1. David Crystal: Anglishtja si Gjuha Globale

David Crystal, në veprën e tij *English as a Global Language* (2003), thekson se anglishtja ka arritur statusin e një "gjuhe globale" për shkak të fuqisë politike, ekonomike dhe teknologjike të shteteve që e flasin atë, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe. Crystal argumenton se anglishtja u bë dominante jo për shkak të numrit të folësve të saj, por për shkak të ndikimit të fortë

që këto shtete kishin në ekonomi, diplomaci dhe teknologji. Ky ndikim ka bërë që shumë gjuhë, përfshirë shqipen, të huazojnë fjalë dhe struktura të ndryshme nga anglishtja.

Në kontekstin shqiptar, anglicizmat janë përhapur kryesisht përmes kontakteve me emigrantët shqiptarë në shtetet anglishtfolëse si SHBA, Britani, dhe Australi. Ata kanë sjellë me vete elemente të anglishtes, të cilat kanë hyrë në përdorim në gjuhën shqipe, veçanërisht në periudha migrimi dhe përkthimesh.

"Përhapja e anglishtes është një rezultat i fuqisë ekonomike dhe politike të shteteve që e flasin atë, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Britaninë e Madhe. Crystal (2003) argumenton se, si rezultat i kësaj fuqie, anglishtja është bërë një gjuhë globale, duke pasur një ndikim të rëndësishëm në gjuhë të tjera, përfshirë shqipen."

2. Rajend Mesthrie: Kontaktet e Gjuhëve dhe Huazimi i Fjalëve

Rajend Mesthrie, në librin e tij *Contact Languages: A Wider Perspective* (1995), analizon se si kontaktet e gjuhëve çojnë në huazimin e fjalëve dhe struktura gramatikore. Sipas Mesthrie, kur dy gjuhë vijnë në kontakt, si rezultat i migracionit, tregtisë, ose përkthimeve, ato mund të ndihmojnë njëra-tjetrën të huazojnë fjalë dhe shprehje. Ky fenomen është i dukshëm kur një gjuhë më e fuqishme, si anglishtja, hyn në kontakt me një gjuhë tjetër, si shqipja.

Në rastin shqiptar, emigracioni ka pasur një rol të rëndësishëm në përhapjen e anglicizmave. Shqiptarët që migruan në vendet anglishtfolëse, si SHBA dhe Angli, sollën me vete elemente të anglishtes që ndikuan në përdorimin e gjuhës shqipe. Kjo është veçanërisht e dukshme në fushën e terminologjisë teknologjike, sporteve dhe kulturës popullore, ku anglicizmat janë futur në mënyrë të natyrshme për të pasqyruar ndryshimet e shoqërisë. "Siç thekson Mesthrie (1995), kur dy gjuhë janë në kontakt, ato shpesh huazojnë fjalë dhe struktura gramatikore nga njëra-tjetra. Ky fenomen është i dukshëm në shqipen, ku anglicizmat janë futur përmes emigracionit dhe kontakteve me anglishtfolësit."

3. J. Algeo: Historia e Përhapjes së Anglishtes dhe Ndikimi i Saj në Gjuhët e Tjera

J. Algeo, në librin e tij *The Origins and Development of the English Language* (2010), përshkruan historinë e përhapjes së anglishtes dhe ndikimin që ka pasur ajo në gjuhët e tjera. Algeo thekson se anglishtja ka fituar një pozicion global për shkak të ndikimit të Perandorisë Britanike dhe dominimit të SHBA-së. Ky ndikim ka çuar në një përhapje të madhe të anglicizmave në shumë gjuhë të botës, përfshirë shqipen.

Në Shqipëri, periudha e pas Luftës së Dytë Botërore dhe rritja e marrëdhënieve me shtetet perëndimore ka ndikuar ndjeshëm në përhapjen e anglicizmave. Anglicizmat kanë hyrë në fushën e shkencës, teknologjisë, dhe kulturës, veçanërisht përmes medias dhe shkollave që ofrojnë mësim në anglisht.

4. J.G. Whorf: Ndikimi i Gjuhës në Mendim dhe Kulturë

Whorf, në teorinë e tij të Sapir-Whorf, sugjeron se gjuha ka ndikim të thellë në mënyrën se si njerëzit mendojnë dhe perceptojnë botën. Kjo teori mund të përdoret për të argumentuar se përhapja e anglicizmave ka ndikuar në strukturat mendore dhe kulturore të shoqërisë shqiptare. Përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve të huaja mund të sjellë ndryshime në perceptimin dhe kuptimin e fenomeneve sociale dhe kulturore.

Në Shqipëri, përhapja e anglicizmave ka çuar në një zhvillim të ri të kulturës dhe mendimit shqiptar. Fjalët dhe shprehjet që janë huazuar nga anglishtja, veçanërisht në fushat e teknologjisë dhe kulturës popullore, kanë krijuar një ndikim të ri në mënyrën e jetesës dhe komunikimit.

1. Anglicizmat dhe huazimet e hershme

Në studimin e tij Xhevat Loshi thekson:

Në shekullin XIX dhe fillim të shekullit XX, ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe ka filluar të bëhet i dukshëm përmes kontakteve me shqiptarët që kishin migruar në vendet anglishtfolëse si SHBA, Angli dhe Australi. Në këtë periudhë, shumë shqiptarë morën njohuri të gjuhës angleze përmes shkollave të huaja ose për shkak të punëve dhe emigrimit.

Shembuj të hershëm të anglicizmave:

"Klub" (angl. "club"): Ky anglicizëm shfaqet për herë të parë në shkrimet e viteve 1900, kur shqiptarët filluan të krijojnë klube dhe organizata të ngjashme me ato anglosaksone. Ky fjalë u përdor për të përshkruar grupe shoqërore, por edhe struktura të tjera sociale që pasqyrojnë modele përfundimtare.

"Dog" (angl. "dog") dhe "cat" (angl. "cat"): Këto fjalë kanë hyrë në shqipe shumë herët, si pjesë e përkthimeve për librat dhe shkrimet e huaja.

2. Përkthimet dhe përdorimi i anglicizmave në letërsinë shqiptare:

Në periudhën e përkthimeve të letërsisë angleze në shqip, anglicizmat bëheshin pjesë e natyrshme e gjuhës. Pjesa më e madhe e përkthimeve ishte nga autorë të njohur si R.L. Stevenson dhe H.G. Wells. Kjo periudhë e pasoi botimin e shkrimeve të mëdha, të tilla si veprat e F. Konicës dhe F. Nolit, të cilët shpesh përfshinin anglicizma në tekstet e tyre për ta pasqyruar ndikimin e anglishtes.

Shembuj të përkthimeve të anglishtes:

Në përkthimin e vjershës së R. L. Stevensonit, "**Ylli lart ndë qiell**", në abetaren e Kristoforidhit, gjejmë përdorimin e disa fjalëve si "**eagle**" dhe "**butterfly**", të cilat janë huazuar nga anglishtja.

Gjatë periudhës kur Shqipëria ishte nën ndikim të kulturave perëndimore, veprat e autorëve të tillë si Defoe dhe Wilde filluan të përktheheshin, dhe me këtë rast, përkthimet përfshinin jo vetëm fjalë të huaja, por edhe struktura të reja stilistike që kishin të bënin me kulturën e anglishtes.

3. Shkolla dhe mësimi i anglishtes:

Në vitet 1920-1930, kur shqiptarët filluan të zhvillonin shkolla me mësues anglezë, ndikuar nga shkollat amerikane dhe britanike, anglishtja u përfshi si lëndë mësimi në disa institucione edukative. Për shembull, Shkolla Teknike që njihej si Shkolla e H. Fulcit, filloi të përdorte anglishten si pjesë të planit mësimor dhe kjo ndikoi në rritjen e numrit të anglicizmave që hyjnë në gjuhën shqipe.

Shembuj të anglicizmave në shkolla:

"Basketball" (angl. "**basketball**"): Pas përhapjes së lojërave perëndimore në Shqipëri, fjalë të tilla si "basketboll" hynë në përdorim të gjerë dhe u bënë të zakonshme në komunikimin sportiv.

"Football" (angl. "**football**"): Po ashtu, futboli është një tjetër anglicizëm që përfshiu terminologjinë shqiptare pas periudhës së parë të njohjes së sporteve perëndimore, dhe ishte përdorur me të madhe gjatë viteve 1920-1930.

4. Migrimi dhe ndikimi në gjuhë:

Në periudhën pas Luftës së Parë Botërore, kur shqiptarët filluan të emigrojnë në SHBA, ndikimi i anglishtes u bë më i theksuar. Kjo ka ndikuar edhe në gjuhën e përdorur nga ata që emigruan, duke çuar në përfshirjen e shumë fjalëve dhe shprehjeve të huaja në fjalorin e tyre të përditshëm.

Shembuj të anglicizmave të periudhës së emigracionit:

"Dollar" (angl. "**dollar**"): Fjalë që është përdorur për të përshkruar monedhën amerikane, dhe u përhap në gjuhën shqipe përmes emigrantëve shqiptarë në SHBA.

"Gangster" (angl. "**gangster**"): Ky anglicizëm u përdor për të përshkruar figura të kriminit të organizuar në kontekstin e emigruar shqiptar që kishte mësuar për këto fenomene përmes kulturës popullore amerikane.

5. Ndikimi i anglishtes pas Luftës së Dytë Botërore:

Pas Luftës II Botërore, me hapjen e Shqipërisë ndaj ndikimeve të jashtme dhe me rritjen e marrëdhënieve me shtetet perëndimore, anglishtja pati një ndikim të madh në fushën e teknologjisë dhe shkencës. Kjo periudhë përfshiu gjithashtu përdorimin e anglicizmave për produktet e teknologjisë, termat ushtarakë dhe të tjerë.

Shembuj të anglicizmave pas Luftës II Botërore:

"Computer" (angl. "computer"): Ky anglicizëm hyri në shqip pas zhvillimeve të teknologjisë, duke u përdorur për të përshkruar pajisje dhe teknologji të reja që vinin nga shtetet perëndimore.

"Internet" (angl. "internet"): Me ardhjen e internetit dhe komunikimin global, ky term hyri në përdorim të gjerë në Shqipëri.

Përdorimi i Anglicizmave dhe Zgjerimi i Fjalorit të Gjuhës Shqipe

Në një kontekst global, ku teknologjia dhe komunikimi ndërkombëtar janë në zhvillim të vazhdueshëm, përdorimi i anglicizmave shpesh paraqitet si një mundësi për të përmirësuar komunikimin dhe për të pasuruar fjalorin e gjuhës shqipe. Megjithatë, kjo duhet të bëhet me kujdes dhe me një mirëkuptim të thellë për ndikimin që mund të ketë ky proces në ruajtjen e identitetit gjuhësor të shqiptarëve.

Një aspekt pozitiv i përdorimit të anglicizmave është se ato shpesh i sjellin gjuhës shqipe terma të rinj dhe koncepte që mund të jenë të vështira për t'u përkthyer direkt në gjuhën amtare. Kjo ndihmon në komunikimin më efikas në fusha të caktuara, veçanërisht në teknologji, shkencë, dhe biznes. Anglicizmat që janë të lidhura ngushtë me zhvillimet moderne të shoqërisë, si "cloud", "digital", "data", dhe "artificial intelligence", kanë krijuar mundësi për të komunikuar më lehtë me botën dhe për të qëndruar në hap me kërkesat e kohës.

Për më tepër, përdorimi i anglicizmave mund të ndihmojë në zhvillimin e një gjuhe më dinamike, që është në përputhje me ndryshimet e shpejta të shoqërisë dhe të teknologjisë. Ata lejojnë krijimin e termave që mund të jenë më të saktë dhe të përshtatshëm për kuptimin e fenomeneve të reja që lindin, duke ofruar mundësi për t'u shprehur në mënyrë më të pasur dhe më të saktë. Ky fenomen gjithashtu ka mundësuar krijimin e një lidhjeje më të ngushtë me kulturat dhe gjuhët e tjera, duke i bërë shqiptarët më të hapur ndaj ndikimeve dhe mundësive globale.

Megjithatë, përpjekjet për të ruajtur identitetin gjuhësor shqiptar duhet të shoqërohen me nisma që mbështesin krijimin e fjalëve të reja dhe shprehjeve në gjuhën shqipe, që mund të zëvendësojnë anglicizmat kur është e mundur. Kjo do të mundësojë që gjuha shqipe të mbetet e pasur dhe e gjallë, duke ruajtur lidhjen e saj me traditën dhe kulturën shqiptare, ndërkohë që përfiton nga mundësitë që ofron globalizimi dhe përdorimi i anglicizmave.

Përmbledhje

Në këtë punim kam shqyrtuar ndikimin e anglicizmave në gjuhën shqipe, duke analizuar burimet, shkaqet dhe pasojat e përhapjes së tyre. Siç u pa, anglicizmat janë një rezultat i kontaktit të gjuhëve dhe shfaqen kryesisht në kontekste ku anglishtja ka një ndikim të fortë ekonomik, teknologjik dhe kulturor. Nëpërmjet referencave teorike nga studiues si David Crystal, Rajend Mesthrie dhe J. Algeo, u argumentua se përhapja e një gjuhe lidhet ngushtë me fuqinë e saj politike dhe ekonomike, siç ka ndodhur me anglishten në shkallë globale.

Në rastin e shqipes, ndikimi i anglishtes është intensifikuar në periudha të ndryshme historike, përmes emigracionit, arsimit, përkthimeve letrare dhe zhvillimit të teknologjisë. Studimi tregoi se anglicizmat janë futur fillimisht në fushat e sportit, ekonomisë dhe shkencës, duke u pasuruar më tej me terma të rinj në epokën e internetit dhe globalizimit.

Megjithëse anglicizmat mund të ndihmojnë në përshtatjen e shqipes me realitetet moderne, ekziston një rrezik i deformimit të strukturës gjuhësore dhe zbehjes së fjalorit autokton. Prandaj, është e rëndësishme të ndërmerren masa për një përdorim të kujdesshëm dhe të ekuilibruar të tyre, duke u siguruar që shqipja të ruajë autenticitetin e saj. Institucionet arsimore, gjuhëtarët dhe mediat luajnë një rol kyç në përcaktimin e normave gjuhësore dhe promovimin e përdorimit të një gjuhe të pasur dhe të saktë.

Bibliografia

1. **Crystal, David.** *English as a Global Language*. Cambridge University Press, 2003.
2. **Mesthrie, Rajend.** *Contact Languages: A Wider Perspective*. Cambridge University Press, 1995.
3. **Algeo, J.** *The Origins and Development of the English Language*. Cengage Learning, 2010.
4. **Whorf, J.G.** *Language, Thought, and Reality: Selected Writings of Benjamin Lee Whorf*. MIT Press, 1956.
5. **Loshi, Xhevat.** "Anglicizmat dhe ndikimi i gjuhës angleze në gjuhën shqipe." *Revista e Gjuhës Shqipe*, 1999.
6. Wikipedia contributors. "Anglicism." *Wikipedia*, <https://en.wikipedia.org/wiki/Anglicism>.

RËNDËSIA E TOLERANCËS FETARE NË SHOQËRITË MULTIETNIKE DHE MULTIKONFESIONALE

Prof.dr. FAHRUSH REXHEPI

ABSTRAKT

Tema “Rëndësia e tolerancës fetare në shoqëritë multietnike dhe multikonfesionale” ka për qëllim hulumtimin, analizën dhe rolin e tolerances dhe lirive fetare në shoqëritë multietnike dhe multikonfesionale në vendet e Ballkanit, me theks të veçantë në Kosovë ku jetojnë disa komunitete multietnike dhe multifetare.

Ideja e ndërtimit të tolerances ndërjetare dhe realizimit të të drejtave të komuniteteve pakicë në shoqëritë multietnike dhe multikonfesionale zakonisht mirret si moster apo si model nga disa vende demokratike të botës perendimore. Mirëpo, ne mendojmë se edhe roli i feve dhe toleranca fetare është mjaftë i rëndësishëm në vendet dhe shoqëritë ku jetojnë komunitetet e ndryshme fetare dhe etnike.

Toleranca dhe dialogu mes popujve dhe shoqërive me diversitete të ndryshme kulturore dhe fetare është në të vërtetë synim dhe një sfidë për të gjitha shoqëritë e rajonit të Ballkanit, por edhe më gjerë. Prandaj, angazhimi i institucioneve fetare, angazhimi i institucioneve akademike shkencore dhe i mekanizmave të tjerë në zhvillimin e proceseve të paqes, të zhvillimit të dialogut ndërjetar, dialogut politik dhe shoqëror, mund të themi se është një vlerë më shumë për emancipimin e shoqërisë në rajonin e Ballkanit dhe të Evropës në përgjithsi.

Fjalët Kyq: Tolerancë, multikonfesionale, dialog, komunitete, shoqëri, etj.

Ekzistimi i shoqërisë multietnike në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut – përceptimet

Historia nëpër të cilën ka kaluar, Kosova, Serbia, Maqedonia, Bosnja dhe disa vende të tjera të Ballkanit si dhe popujt e tyre, e sidomos rrethanat pas luftrave të fundit, në këto shtete, kanë krijuar ndasi të mëdha mes komuniteteve, me theks të veçantë në mes atij shqiptar dhe serb dhe atij shqiptar dhe maqedon.

Pas përfundimit të këtyre konflikteve dhe krijimit të stabilitetit me ndërmjetsimin e faktorëve ndërkombëtar, njëra nga temat më të përfolura në 25 vitet e fundit ka qenë shoqëria multietnike, multikonfesionale dhe bashkjetesa mes të gjithë komuniteteve.

Pas pushtimit të gjatë dhe mëpas luftës shkatruese të bërë nga Serbia, një pajtim dhe bashkëjetesë dukej i pamundur. E kaluara e hidhur e popullit të Kosovës si pushtimi, lufta, viktimat, dhunimet, të zhdukurit etj., ngritja e një shoqërie të tillë dhe bashkëjetesa mes të gjithë komuniteteve, e sidomos mes atij shqiptar dhe serb, kërkon kohë, mund dhe sakrificë për tu jetësuar.

Shoqëria e bazuar në vlerat si: integrim, mirëkuptim të ndërsjell, tolerancë dhe bashkëjetesë është më tepër një dëshirë se sa një realitet. Këto vlera ekzistojnë mes shqiptarëve shumicë që përfshinë 90% të popullsisë³⁵ dhe komuniteteve jo serbe. Sa i përket komuniteteve turqë, boshnjakë dhe goranë, kanë shkallën më të lartë të integritetit dhe ata kanë përfituar nga centralizimi. Mirëpo, një pjesë e serbëve, Akoma janë të ndikuar nga politika e Beogradit dhe nuk dëshirojnë të integrohen në shtetin e Kosovës dhe të përfitojnë nga ky integrim.

Për sa i përket Kosovës, ekzistojnë mendime të ndryshme nëse Kosova është shoqëri multi-etnike. Edhe pse Kosova sipas planit të Ahtisarit zyrtarisht konsiderohet shoqëri multi-etnike ngase në të jetojnë një numër i nacionaliteteve dhe i komuniteteve të ndryshme, megjithatë dihet mirëfilli se në Kosovë jetojnë mbi 90% shqiptar dhe mbi 95% musliman që do të thotë se praktikisht Kosova nuk është shoqëri multi-etnike dhe multikonfesionale. Sipas Esat Stavileci “Kosova nuk përbënë mozaik nacional”.³⁶

Në Kosovë edhe pse ekzistojnë ndasi të mëdha në mes të komuniteteve, sidomos në mes atij shqiptar dhe serb, është e mundur të ketë bashkëjetesë, nëse serbët e Kosovës e kuptojnë realitetin e ri në Ballkan dhe nëse ata e konsiderojnë veten e tyre si qytetarë të barabartë me të tjerët dhe e njohin shtetin e Kosovës.

Vlera e shoqërisë dhe bashkëjetesës të të gjitha komuniteteve, konsiderohet një faktor i rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë, si dhe në shtetbërjen dhe shtetndërtimin e Kosovës. Shoqëria e shëndoshë tolerante multi-etnike është imperativ për stabilitet politik në Kosovë, kur shoqëria kosovare nga të gjitha komunitetet e kupton rolin dhe pozitën e saj, shqiptarët shumicë dhe komunitetet tjera pakicë. Nëse secila nga komunitetet e kuptojnë pozitën e tyre të barabartë, atëherë do të arrihet një besim i ndërsjellë mes të gjitha komuniteteve.

Kjo krijon mundësinë për zhdukjen e konflikteve ndëretnike, ndërkonfesionale sepse “njerëzit nuk mund të bashkohen lirisht për të mbështetur synimet e tyre pa pasur njëfarë besimi te njëri tjetri”.³⁷ Me siguri që promovimi i barazisë dhe i tolerancës ndëretnike dhe ndërjetare mundëson progresin dhe integrimin në këtë rast të Kosovës në strukturat euroatlantike dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Gjithashtu mundëson rritjen e mirëqenies sociale dhe ekonomike.

Një shoqëri e tillë është kusht për konsolidimin e demokracisë, veçmas në rajonin e Ballkanit të trazuar nga luftërat sepse “institucionalizim i arenave për dialog e diskutim mes shumicës së shoqërisë dhe pakicave, është elementi më i qartë i kuptimit demokratik...”.³⁸ Gjithëashtu edhe për pranimin e Kosovës si subjekt i pavarur ndërkombëtar, “me fjalë të tjera, demokracia me pjesëmarrje multi-etnike mund të bëhet më e mirë për pavarësi”.³⁹

³⁵ Enver hoxhaj, “politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës”, Pejë, 2008.

³⁶ Esat Stavileci, 2008.

³⁷ Robert A, Dahel, “Politiarka”, Tiranë, 2005.

³⁸ Knut Midgard, Erik Rasch Bjorn, “Demokracia kushtet dhe pasojat”, Prishtinë, 2008.

³⁹ Januz Bugajski, “Ngritja e Kosovës”, Prishtinë, 2006.

Duke e ditur rëndësinë e shoqërisë, të drejtat e komuniteteve janë të garantuara me kushtetutën e vendit, pra të Kosovës e cila thotë “Pjestarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirishtë identitetin dhe atributet e tyre si komunitet”.⁴⁰

Mirëpo, pavarësisht të drejtave që i gëzojnë komunitete pakicë në Kosovë me kushtetutën e Republikës së Kosovës, integrimin dhe shfrytëzimin e këtyre të drejtave shpeshëherë e pengon nacionalizmi etnikë në Kosovë. Para se të japim skjarime të tjera, është e nevojshme ta kuptojmë vetë nocionin nacionalizëm. Sipas Lain Mc Lean “Nacionalizmi e kthen përkushtimin ndaj kombit në parime ose programe”.⁴¹ Apo nacionalizmi mund të jetë “Një forcë përparimtare çliruese”⁴² ose “Një kredo e pa arsyeshme dhe reaksionare”⁴³

Sa i përket Kosovës mundë të thuhet se shoqëria multietnike paralizohet nga nacionalizmi etnik. Ekziston një antagonizëm i thellë në mes të nacionalizmit etnik shqiptar dhe atij serb. Mirëpo një nacionalizëm i tillë nuk është pengesë në mes komunitetit shqiptar dhe komuniteteve tjera jo serbe. Nacionalizmi etnik shqiptar dhe ai serbë janë të ndryshëm. Një nacionalizëm i tillë ndikon edhe në Shtetbërjen e Kosovës dhe në Shtetndërtimin e sajë dhe në krijimin e një shoqërie multietnike. Nacionalizmi etnik serb ndikon negativisht tek serbët që jetojnë në Kosovë, “bashkështetasit serb janë kundër, sepse ashtu janë të ndërtuar në shekuj dhe edhe tani atë ndërtim po e nxitë e keqpërdorë klasa politike nacionaliste e Beogradit.”⁴⁴

Sa i përket Maqedonisë Veriore, pas luftës dhe represionit maqedonas ndaj shqiptarëve një pajtim dhe bashkjetesë dukej pothuajse e pamundur. Konflikti, viktimat dhe sulmet e herë pas hershme të grupeve të rinjëve maqedonas ndaj qytetarëve të nacionalitetit shqiptarë në Maqedoni dhe rasti i Kumanovës, kërkojnë kohë, mund dhe sakrificë për ngritjen e një shoqërie paqësore multietnike, multikonfesionale dhe tolerante. Megjithatë mendojmë se ekzistojnë rrugë dhe mënyra në tejkalimin e këtyre pengesave.

Përceptimet rreth shoqërisë multietnike në Maqedoninë e Veriut mendojmë se janë relativisht të sakta. Në Maqedoninë Veriore ekzistojnë komunitete të ndryshme me gjuhë, kulturë, prejardhje, religjione dhe tradita të ndryshme. Përveç dy nacionaliteteve më të mëdha ai maqedonas dhe shqiptar në këtë shtet jetojnë edhe etni boshnjake, turke, serbe, vllehe ,rome etj.

Kjo shoqëri me disa etni në vendet e zhvilluara demokratike konsiderohet, si një shoqëri e ngritur mbi vlerat njerëzore dhe demokratike. Mirëpo, për të ekzistuar një shoqëri e tillë mbi themelet e një shoqërie të shëndoshë, duhet ndërtuar paqën, tolerancën, mirëkuptimin dhe përmirësimin e kohezionit në shoqëri. Për disa si dhe për bashkësinë ndërkombëtare, shoqëria multietnike ndoshta nënkupton shoqëri dyetnike, maqedonasit dhe shqiptarët, ndërsa etnitetet tjera nuk konsiderohen si etni me përparsi të barabarta.

Në Maqedoninë e Veriut edhe pse ndonjëherë ekzistojnë ndasi në mes të komuniteteve, sidomos në mes atij maqedonas dhe shqiptarë, është e mundur të ketë bashkjetesë dhe paqë nëse edhe shqiptarët i gëzojnë të drejtat e tyre të barabarta me maqedonasit.

⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008, Neni 57, Alinea 3.

⁴¹ Lean Mc, “Fjalori Politik”, Tiranë, 2001.

⁴² Hejwood Andre, “Politika”, Prishtinë, 2008.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Ibrahim Kelmendi, “Sfidat e radhës”, Prishtinë, 2008.

Për ta mbajtur në paqë dhe në harmoni një shoqëri multietnike dhe multikonfesionale, duhet të jenë të garantuara të drejtat e komuniteteve me kushtetutën e vendeve në të cilin jetojnë ato, e veçmas kjo vlenë për Serbinë e cila gjithnjë e më tepër po i diskriminon shqiptarët e Luginës së Preshevës, si dhe pakicat tjera që jetojnë atje, madje edhe duke ua shlyar adresat.

Toleranca ndërfetare dhe ndërtimi i paqes

Përveç shkrimeve të shumta dhe publikimeve nëpër gazeta e revista të ndryshme dhe përveç veprave shkencore që janë shkruar lidhur me tolerancën, paqen, lirinë e bindjes politike, lirinë e përcaktimit fetar, për këto tema diskutohet edhe në shumë simpoziume, konferenca, sesione shkencore dhe në shumë programe të mediave elektronike vizuale. Një nga shprehjet e shpeshta dhe të zakonshme që sot përdoret edhe nga studiues të ndryshëm edhe nga liderët politik dhe ata fetarë, është toleranca ndërtnike dhe ndërkonfesionale. Me vetë faktin se kjo shprehje përdoret sot aq shpesh, na bënë të kuptojmë se ky problem ende nuk është tejkaluar, në vendet e Ballkanit apo në shoqëritë tjera të botës së shekullit 21.

Çfarë nënkuptojmë me nocionin “tolerancë” ?. Në fakt kjo është një shprehje, e cila rrjedhë nga fjala latine “tolere”, e që ka përkufizimin e durimit, mirëkuptimit dhe zemërbutësisë ndaj mendimeve të të tjerëve.⁴⁵ Në gjuhën arabe apo në literaturën islame për shprehjen tolerancë përdoret fjala “tesamuh”, e cila për nga përmbajtja ka një kuptim më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës. Në tolerancën islame nuk ekziston ajo që njeriu të detyroj vetveten që të bëj diçka që nuk është pjesë e traditës së tij, por që njeriu të pranoj dhe të pajtohet me realitetin dhe ta pranoj tjetrin ashtu siç është ai. Islami dhe detyrimi sikur dhe islami e imponimi janë në kundërshtim njëri me tjetrin, janë dy pole të kundërta të realitetit botërorë ⁴⁶.

Nëse i analizojmë dhe i zbërthejmë mirë burimet kryesore të fesë islame, kur’anin dhe traditën profetike, do të shohim se që të dya këto burime me normat dhe rregullat e tyre në mënyrë reale trajtojnë çështjen e tolerancës dhe të bashkjetesës ndërmjet besimtarëve me përkatësi të ndryshme fetare dhe nacionale. Në vazhdim do ti citojmë disa ajete kur’anore në të cilat theksohet qartë liria e besimit, si ajeti; “Thuaj: e vërteta është nga Zoti juaj, prandaj kushdo le të besoj, kushdo le të mos besoj”.⁴⁷

Koncepti i tolerancës ndaj besimeve të tjera vërehet edhe në ajetin tjetër, në të cilin thuhet; “Ti këshillo, ti je vetëm këshillues. Ti ndaj tyre nuk je detyrues”. ⁴⁸

Islami nga besimtarët e vet jo vetëm që kërkon dialog, tolerancë, mirëkuptim me pjestarët e feve tjera, por ai shkon edhe më larg dhe nga tolerance kalon në shkallën e njohjes, që është shkalla më e lartë e tolerancës dhe garanci për bashkjetesë në mes shoqërive multikonfesionale dhe multinacionale. Kur’ani si libër hyjnorë që të tri fetë i quan fe qiellore dhe i fton për bashkpunim me këto fjalë: “O ithtarë të librit ejani të bashkohemi (të dialogojmë) rreth gjërave të përbashkëta edhe për ju edhe për ne: të adhurojmë

⁴⁵ Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe vlerat që Islami përcjellë në këtë integrim, (Simpozium ndërkombëtar), Forumi musliman i Shqipërisë, Kavajë, Shkurt 2008.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Kuran: El-Kehf, 29.

⁴⁸ Kuran: El-Gashie, 22-23.

vetëm një Zot e mos t'i bëjmë asnjë shok Atij dhe mos ta marrim njëri-tjetrin për Zot, në vend të Perëndisë".
49

Në lidhje me tolerancën në traditën profetike, Muhamedi a.s. si interpretues ligjtim i kuranit, më së miri i sqaroi parimet dhe idealet e larta kuranore, që kanë të bëjnë me tolerancën, drejtësinë dhe lirinë e besimit. Ai me shembullin e vet i bëri traditë praktike këto parime dhe u bë model edhe për brezat e ardhshëm. Ai kishte thënë: "Drejtësia mbanë qiellin dhe tokën".

Roli i fesë në shoqëri

Roli i fesë dhe kontributi i bashkësive fetare si dhe bashkpunimi i tyre me institucionet publike shtetore në ndërtimin e paqes dhe të tolerances dhe në zhvillimin e proceseve multikonfesionale, multinacionale si dhe në ato politike dhe integruese në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit, është shumë i rëndësishëm dhe mund të themi se është një vlerë më shumë për emancipimin e shoqërisë së këtyre vendeve dhe një përgjegjsi sa fetare e humane po aq edhe politike e shtetore për të cilat ka nevojë çdo vend.

Edhe në opinionin dhe ligjërimin politik e akademik perëndimor hasim pikëpamje të shumta mbi natyrën, vendin dhe rolin e fesë në botë në përgjithësi dhe të islamit në veçanti, për sa i përket aspektit politik dhe zgjidhjes së konflikteve. Janë interesante dhe me rëndësi dy vlerësime. Njëri është i kryerabinit të Anglisë, dr.Xhonatan Soks, i cili ka thënë: "Feja është bërë forcë madhore në formësimin e ngjarjeve në botë dhe nëse nuk është pjesë e zgjidhjes, është me siguri pjesë e problemit".

Ndërsa vlerësimi tjetër është i ish presidentit të SHBA-ve, Xhimi Karter, i cili është shprehur: "Vitet e fundit besimi fetarë ka hyrë në një shkallë të pabesueshme në mbretërinë e politikës...dhe se ...ka një prirje drejtë fundamentalizmit në të gjitha fetë".⁵⁰ Ideja se teologjia ndikon shumë në politikën shtetore amerikane është objekt shtjellimi edhe në 400 faqet e librit të Kevin Filips me titull "American theocracy".⁵¹

Ne mendojmë se bota sot, por edhe shoqëritë tona në Ballkan kanë nevojë për energji fetare, të cilën shumë vende po e shfrytëzojnë ngase laicismi është treguar i pasuksesshëm në zgjidhjen e problemeve shoqërore e veçmas atyre morale e shpirtërore.

Ajo që mundë të konkludojmë në fundë të këtij kapitulli është se sa i përket tematikave të ndërlidhura me El Ilahijat janë plotësuar dhe janë një material shumë i rëndësishëm për të marur në bazë të fortë të njohurive ftare, një shikim anlitik do të jep të ditur lexuesit se rëndësia e tmës e ka detyruar redaksinë që në të gjitha anët të e përfshij këtë tematik, herë nga këndi fetar e herë tjera nga ai shkencorë që shtyn deri në besim sic e theksuam më lartë.

⁶⁵ Revista Hëna e Re, Abdur Rahman Abdul Halik, përktheu Ilmi Krasniqi, viti 10, nr.123, shtator 1996, f. 16.

⁶⁶ Revista Hëna e Re, Shtojca për fe,kulturë dhe shkencë GJURMA, punim I Redaksisë, viti 3 , nr.12, gusht 1999, f.

⁶⁷ Revista Hëna e Re, Abdur Rahman Abdul Halik, përktheu Ilmi Krasniqi, viti 10, nr.124, dhjetor 1996, f. 16.

⁶⁸ Revista Hëna e Re, Shaban Rahmani, Abdur Rahman, viti 19, nr.194, prill/maj 207, f. 20.

⁶⁹ Revista Hëna e Re, Vincent Cornell, viti 19, nr. 203, prill 2008, f. 21.

⁷⁰ Revista Hëna e Re, Nexhat Ibrahimimi ?, viti 21, nr. 222, nëntor 2009, f. 17.

⁷¹ Revista Hëna e Re, Orhan Bislimaj, viti 23, nr. 228, maj 2010, f. 19.

⁷² Revista Hëna e Re, Redaksia, viti 29, nr. 294/296 mars/ maj 2016, f. 50,52.

⁷³ Revista Hëna e Re, Driton Bajrami, viti 30, nr. 306, mars 2017, f. 32.

⁷⁴ Revista Hëna e Re, Driton Bajrami, viti 30, nr. 307, prill 2017, f. 23.

⁷⁵ Revista Hëna e Re, Driton Bajrami, viti 30, nr. 308, maj 2017, f. 32.

⁷⁶ Revista Hëna e Re, Driton Bajrami, viti 30, nr. 310, korrik 2017, f. 12.

⁷⁷ Revista Hëna e Re, Husejn Riza, viti 30, nr. 315, dhjetor 2017, f. 18.

⁷⁸ Revista Hëna e Re, Behrim Jusufi, viti 31, nr. 316, janar 2018, f. 32.

⁷⁹, Shtojca për fe,kulturë dhe shkencë GJURMA, Qufli Osmani, viti 2 , nr. 4, mars 1998, f. 8.

Ndërsa për sa i përket kapitullit të **En Nubuvat (Pejgamberia)** që ndërlidhet me pejgamberinë është folur mbi fenomenin e shpalljes, mbi Pejgamberët mbi Muxhizen, mbi dyshimet të cilat kanë të bëjnë mbi vërtetësinë e shpalljes, gjithashtu edhe mbi dyshuesit rreth shpalljes dhe kundërpërgjigjëjet ndaj tyre.

Kështu e vërtetë, temën “Shpallja bazë e fes së vërtetë”⁸⁰ e autorit Shaqir Fetahu, gjithashtu redaksia do të jep këtë titull dhe shqyrton rëndësinë dhe vlerën e të dërguarve me temën “Të dërguarit e Zotit”⁸¹,

Ndërsa në **El Gajbijat** jo vetëm që janë shtjelluar tema me rëndësi mirpo mbi këto është spjeguar edhe vet konceptit i besimit në gajb të fshehtë sic është studimi i Miftar Islamit me temën “Besimi në botën e ardhshme”⁸² dhe Jusuf Zimeri me temën “Besimi në gjërat e fshehta”⁸³, duke e analizuar mirë një anomali e cila ekziston cdoherë, e që në kohën tonë mer edhe përmësa me të mëdha besimin në ahiret me anlizën të cilën e sjellë studijuesi Mehmet Mallkoc duke iu referuar shtjellimeve dhe zgjedhjeve të cilat i ofron Imam Maturidiu rreth kësaj problematike “Shkaqet që pengojnë të besuarit në ahiret sipas Maturidiut”⁸⁴, gjithashtu tema që redaksia e Revistës Hëna e Re do të ia kushtoj Ditës së gjykimit⁸⁵ më një elaborat shumë konciz të temës dhe shtjellimi Jetës pas vdekjes⁸⁶, gjithashtu në këtë sferë do të sqarohet edhe besimi në peshoren dhe mizanin me temën “Besimi në Mizan”⁸⁷, dhe tema si “Përjetësia e botës”⁸⁸ dhe të tjera.

Duke u nisur nga fakti se muslimanet e ketyre viseve i takojne Shkollës Hanefite në jurisprudencë dhe Ehli Sune vel el Xhmatit në Akaid, besim Revista Hëna e Re do të ofroj në numrta e sajë qasje, shpjegime dhe elaborime të këtij kapitulli shkollës **Maturidite dhe Esh’arite** dhe mësimave të tyre në shumë nivele nga të cilat në vazhdim do të theksojmë disa prej tyre si p.sh. “Kontributi i Ebu Hanifes në akaidologji”⁸⁹, dhe po të njetën temë edhe Nexhat Ibrahim⁹⁰, gjithashtu “Ebu Hanifja, themelues i shkencës së kelamit (Akaidit)”⁹¹, poashtu “Koncepti akaidologjik i Ebu Hanifes”⁹² dhe si vazhdimësi e kësaj në aspekt sistematik do të rrjedhin edhe punimet të cilat ndërlidhen me Imam Maturidiun dhe shkollën e tij, si “Imam Maturidiu përfaqësues i shkollës hanefite”⁹³ nr. 354, dhe sqarime në tema diferenciale si p.sh studimi mbi tezën “Allahu e ka shkruar, Allahu ka bërë emër, Imam El Maturidiu”⁹⁴, e deri tek ato më të

⁸⁰ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 19, nr. 19, gusht 2007, f.36.

⁸¹ Revista Hëna e Re, Redaksia, viti 13, nr. 153, prill 2000, f. 15.

⁸² Revista Hëna e Re, Miftar islami, viti 19, nr. 203, prill 2008, f. 26.

⁸³ Revista Hëna e Re, Jusuf Zimeri, viti 31, nr. 31, shkurt 2020, f. 21.

⁸⁴ Revista Hëna e Re, Mehmet Mallkoc, përktheu Muin Sulejmani, viti 32, nr. 328, janar 2019, f. 32.

⁸⁵ Revista Hëna e Re, Redaksia, viti 29, nr. 293, shkurt 2016, f. 27.

⁸⁶ Revista Hëna e Re, Meulana M. Ali, viti 14, nr. 181, prill 2005, f. 9.

⁸⁷ Revista Hëna e Re, Atulla Aliu, viti 11, nr. 131, qersho 1997, f. 19.

⁸⁸ Revista Hëna e Re, Muhamed Gazali, viti 10, nr. 123, shtator 1996, f. 15.

⁸⁹ Revista Hëna e Re, Redaksia, viti 19, nr. 185, prill 2006, f. 48.

⁹⁰ Revista Hëna e Re, Nexhat Ibrahim viti 19, nr. 211, dhjetor 2008, f. 32.

⁹¹ Revista Hëna e Re, Muzemil Osmani, viti 24, nr. 237, mars 2011, f. 35.

⁹² Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 29, nr. 293, 294, shkurt, mars 2016, f. 40, 22.

⁹³ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 29, nr. 293, 294, shkurt, mars 2016, f. 40, 22.

⁹⁴ Revista Hëna e Re, Dr. Ejub Ali përktheu Nexhat Ibrahim, viti 19, nr. 214, mars 2009, f. 19.

komplikuarat si p.sh. “Rëndësia e sistemit të mendimit tek Imam Maturidiu”⁹⁵, mirpo kjo asesi nuk e bënë që studimet mbi Imam Esh’ariun të jenë më të zbehta por githsesi do të e merr vendin e merituar në faqet e kësaj reviste nga të cilat mundë të vecojm temat më me rëndësi “ Abu Hasan El Eshari dhe vënia e themeleve të shkollës së tij”⁹⁶ është një studim më rëndësi ku autori në disa numra i sqaron parimet e shkollës së Eshariut⁹⁷ dhe “Për Eshariun me dy shkëputje”⁹⁸ ku autori sjell disa pjesë nga vete veprat e Eshariut mbi çështjen e atributve të Zotit dhe të folurit e Zotit.

Pjesë e rëndësishme e shtjellimeve akaidologjike në revistën Hëna e re janë edhe shtjellimet e ndryshme mbi **fraksionet islame**, “Historia e frkacioneve”⁹⁹, “Shkaqet e paraqitjes së fraksioneve në islam”¹⁰⁰, ku më së tepërmi vëmendje do të marin Mutezilitët dhe shtjellimet e tyre e kjo që nga studimet e Shaqir Fetahut i cili do të e sjelle në një formë të bukur dhe mirë të analizuar drejtimin Mutezilit duke filluar me temën “Drejtimi racionalist mu’tezilit në apologjetiken islame”¹⁰¹, duke vazhduar me “Koha dhe vendi i paraqitjes së drejtimin racionalist mu’tezilit”¹⁰² poashtu “Parimet kryesore të mësimin akaidologjik Mutezilit”¹⁰³ dhe duke i dhuruar në dy numra shpjegime reth të parit e Zotit me titullin “Çështja e takimit të Allahut te Mutezilitet”¹⁰⁴, dhe kësaj temi i janë qasur disa here me studime të ndryshme si “Zanafilla e mu’tezilëve”¹⁰⁵, gjithashtu edhe në tri numra radhazi racionalimi do të elaborohet në mënyrë rënjësores “Racionalizmi i mu’tezilëve”¹⁰⁶ dhe kjo do të ndërlidhet edhe me një segment të rëndësishëm të kësaj shkolle me temën “Parimet e mu’tezilitëve”¹⁰⁷, dhe analiza të plota mbi drjetimin Mutezilitet titulluar “Një analizë e plotë mbi drejtimin Mutezilit”¹⁰⁸.

Gjithashtu edhe studimet mbi fraksionet islame si shtjellimi mbi “Shkaqet e paraqitjes së frkacioneve në islam”¹⁰⁹, gjithashtu edhe Havarixhët sic është studime me titull “ Harixhinjtë dhe analogjia”¹¹⁰.

Mirpo derisa flasim mbi frkacionet e ndryshme dhe shtjellimet reth tyre gjithsesi se paraqitja e **sekteve të ndryshme në botën islame** hapsirën islame dhe reflektimet e saja në hapsirën tonë ka kërkuar që nga Institucioni i Bashkësis fetare të jepë përgjigjëje e kjo është bërë

⁹⁵ Revista Hëna e Re, Muin Sulejmani, viti 31, nr. 259, janar 2013, f. 49.

⁹⁶ Revista Hëna e Re, Hasan Xhillo, viti 30, nr. 311, gusht 2017, f. 34.

⁹⁷ Revista Hëna e Re, Hasan Xhillo, viti 30, nr. 311,312,313.

⁹⁸ Revista Hëna e Re, Abdulkërim Iseni, viti 34, nr. 360, mars 2022, f. 32.

⁹⁹ Revista Hëna e Re, Shtojca për fe, kulturë dhe shkencë Gjurma, Metin Izeti, viti 1, nr. 1, tetor 1997, f. 5.

¹⁰⁰ Revista Hëna e Re, Musli Bajrami, viti 28, nr. 283, prill 2015, f. 24.

¹⁰¹ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 28, nr. 289, tetor 2015, f. 24.

¹⁰² Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 28, nr. 290, nëntor 2015, f. 24.

¹⁰³ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 28, nr. 291, dhjetor 2015, f. 46.

¹⁰⁴ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 28, nr. 289, tetor 2015, f. 24.??

¹⁰⁵ Revista Hëna e Re, Xhemil Sadiku, viti 30, nr. 30, janar 2017, f. 46.

¹⁰⁶ Revista Hëna e Re, Hasan Xhillo, viti 30, nr. 308, maj 2017, f. 52.

¹⁰⁷ Revista Hëna e Re, Abdulkërim Iseni, viti 30, nr. 310, korrik 2017, f. 44.

¹⁰⁸ Revista Hëna e Re, Shinazi Memedi, viti 32, nr. 341, shkurt 2020, f. 54.

¹⁰⁹ Revista Hëna e Re, Musli Bajrami, viti 28, nr. 283, prill 2015, f. 24.

¹¹⁰ Revista Hëna e Re, Shinazi Memedi, viti 30, nr. 312, shtator 2017, f. 52.

nëpërmjet të Revistës Hëna e Re, tema “Çka janë sektete dhe si veprojnë ato”¹¹¹, është një studim i thuktë që ofron një tablo të sqaruar mirë mbi sektet dhe mënyrën e veprimit dhe si të dallohen sepse at në të shumtën e raste veprojnë të mbuluar me petkun e islamit dhe tesavufit.

Prej sekteve për të cilët që herët është shkruar është Kadianizmi¹¹² dhe Behaizmi me temën “Lëvizja Behaite”¹¹³, gjithashtu “Behaizmi dhe doktrinat e tij”¹¹⁴.

Mirpo je vëtm kjo studijuesit do të i qasen edhe ateizmit sic është tema “Boja e harxhuar e ateizmit”¹¹⁵, “Natyra e mosbesimit”¹¹⁶, gjithashtu dhe ideve të ndryshme të cilët dilnin në sipërfaqe dhe kishin për qëllim futjen e dyshimeve të parimet e besimit dhe konditata fetare si p.sh “Besimi dhe problemet e kohës”¹¹⁷, “Feja fenomen i vërtetë dhe nevoj e patjetërsueshme”¹¹⁸ “Feja dhe zanafilla e sajë”¹¹⁹ Besimi lind me njeriun”¹²⁰, “Besimi ndenjë e paralindur”¹²¹, “Dyshimi në racionalitetin absolut”¹²² e deri te ato sutdime komparative si kjo “Besimi fetar dhe shëndeti mendorë”¹²³ dhe konceptet e shumë përfolura si e drjta e besimit dhe qëndërii i islamit mbi te sic elaborohet ne temen ene fjalë “Liria e besimit në Islam”¹²⁴.

Gjithashtu edhe ato studime akaidologjike si “Aspektet filozofike te Kelamit”¹²⁵ “Ajetet kërkojnë inerpretim”¹²⁶, “Filozofi islame dhe kelami”¹²⁷, si dhe tematika tjera të ndërlidhurame cështje akaidologjike.

Tematikat filozofike ne Revistën Hëna e Re

Sic edhe u trajtua më lartë se tematikat e ndëlidhura nga lëmia e besimit dhe ceshtjeve akaidologjike do ti I gjeme qe nga numrat e pare te Revistes Hën e Re, dhe kjo sipas meje nderlidhet me vet misionin revistes, gjithashtu do te verjme se studimet filozofike do te vijne me vone ne shprehje ne faqet e revistes Hëna e re, dhe kjo sipas mendimit tim do te ndodhe per disa

¹¹¹ Revista Hëna e Re, Rejhan Neziri, viti 28, nr. 361, tetor 2015, f. 24.

¹¹² Revista Hëna e Re, Muhamed Mustafa, viti 9, nr. 100, maj 1995, f. 20, dhe me të njetin titull Kadianizmi do të shkruaj edhe Shaban Aziri, në numrin 104.

¹¹³ Revista Hëna e Re, Avni Aliu, viti 9, nr. 110, tetor 1995, f. 15.

¹¹⁴ Revista Hëna e Re, Muzemil Osmani, viti 28, nr. 284, maj 2015, f. 18.

¹¹⁵ Revista Hëna e Re, Taxhudin Hamidi, viti 32, nr. 341, shkurt 2020, f. 45.

¹¹⁶ Revista Hëna e Re - Gjurma, Sejid Ebul Ala El Mevdudi, viti 2, nr. 14, shtator 1999, f. 1.

¹¹⁷ Revista Hëna e Re, Naim Ferati, viti 7, nr. 55, qershor 1993, f. 20.

¹¹⁸ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 7 nr. 66, nëntor 1993, f. 20, dhe vazhdim e sajë në numrin 67 po të njëjtës revistë.

¹¹⁹ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 8, nr. 69, janar 1994, f. 24.

¹²⁰ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 8, nr. 70, shkurt 1994, f. 24.

¹²¹ Revista Hëna e Re, Shaqir Fetahu, viti 28, nr. 289, tetor 2015, f. 24.

¹²² Revista Hëna e Re, Hamdi Thaci, viti 14, nr. 181, prill 2005, f. 10.

¹²³ Revista Hëna e Re, Mustafa Koçlu, viti 27, nr. 277, tetor 2014, f. 26.

¹²⁴ Revista Hëna e Re, Ragip Serxhani perktheu Mevlad Collaku, viti 29, nr. 295, prill 2016, f. 39.

¹²⁵ Revista Hëna e Re, Hasan Xhillo, viti 30, nr. 307, prill 2017, f. 44.

¹²⁶ Revista Hëna e Re, Hasan Xhillo, viti 28, nr. 358, tetor 2015, f. 24.

¹²⁷ Revista Hëna e Re, Ahmed Fuad El Ehvani përktheu Rejhan Neziri, viti 6, nr. 48, shkurt 1993, f. 16.

shkaqe, fillimisht nga mesazhi dhe synimi I vet revistes dhe e dyta nga natyra e revistes e cila ishte, kulturore, edukativo arsimore dhe informative.

Para se te flas mbi tematikat filozofike dua te bej nje sqarim qe e shoh te rendesishme per lexusin se perse I kam perfshire dy lemi te ndryshme derisa ne realitet cdonjera prej tyre jane te ndara dhe mjaftonte te jet teme ne veti e qe sigurisht se munde te jete cdonjera prej tyre teme ne vete dhe shqyrtim I posaqem qe mendoj se ndonjeri prej studjueve te rinj do te e bejte kete ne te ardhmen por duke e parë struktutren e punimeve dhe tematikat e shtjelluara, hasi ate lidhshmeri te temave te cilat nderlidhen me qasjen akaidologjike dhe ajo filozofike qe ju perngjajne atyre studimeve akaido- filozofike dhe se temat e trjatuara filozofike nuk jane studime dhe perkthime filozofike ne teresi dhe kjo me shtyri qe keto punim te e mar kete cështje ne kosiderat dhe se perfshira e ketyre dy disiplinave do te e pasuroj edhe me shume kete punim modest.

Nese I numerojme ne menyre te pergjithshme gjithsej kemi 51 artikuj nga te cilet 37 punime jane autoriale dhe pjesa tjeter jane perkthime, kur jemi ketu te potencojme se ne kete lemi paraprine Dr. Muhamed Mustafa, gjithashtu edhe profesor Dr. Hasan Xhilo me perkthimet dhe trjatesat e tyre shume të rëndësishme në sferën filozofike.

Per sa I perket lemive vlen te theksojm se punimet jane me së shumti autoriale vetëm tetë prej tyre janë përkthime dhe trajtohen tema kyce sic jane emertimi I filozofise islame¹²⁸ ne me tepre se nje artkiuj dhe ne periudha te ndryshme do ta hasim tematiken e ndikimt te filozofise islame ne ate europiane¹²⁹, gjithashtu raporti I fese me filozofise dhe shqyrtimet mbi filozfet islam si El Kindiu, El Farabiu¹³⁰, Ibn Sina¹³¹ gjithashtu nuk mungojne edhe shqytrimet komparative ne mes te filozofise dhe tesavufit¹³², fikhut e derti tek ato studime komprative ne mes te Platonit, mutezilitëve dhe ilumistëve¹³³.

Nuk është e panjohur për lexuesin fakti se nuk jane trjatuat probleme te thella filozfike dhe se kjo korespodonte me natyen e revistes.mirpo nese bejme nje krahasim ne mes te temave te shtjelluar ne Henen e re ne lemine e akaidit dhe apologjetikes ku ne mes te atyre shtjellimeve dhe hulumtimeve shume te thukta kishim edhe punime te studijuesve te rinj te cilet duke u nisur nga perpjekja per te shprehur temen ashtu sic e shihnin dhe e njihnin do te shohim se nuk ishin ne nivlejn e temes, sikur se në temat e trjatuat ne fillozofi snuk e gjejme dhe mund të themi se

¹²⁸ Emertimi I filizofise islame – Nexhat Ibrahimi (207)

¹²⁹ Ndikimi I filozofise islame ne ate eurpojane – Muhamed Mustafa (5/38,39)

¹³⁰ Farabiu dhe filozofia e tij M. Mustafa (81,82,84,85)

¹³¹ Vlen te permendime se Ibn Sina dhe filozofija e tij kishte me se shumti punime ne Hener e re gjithsej katermbdhjet punime, ne mes te shkrimeve autoriale dhe perkthimeve, si p.sh. Atributet e qenies se domosdoshme tek ibn Sina, Hamdi Thaci (129,130), Muhamedm Mustafa, Ferat Polisi, Hasan Xhilo etj.

¹³² Filozofia dhe Tseavufi – El Ehvani (7/49) perkthim Rejhan Neziri.

¹³³ Platoni, mutezilitet, iluministet, - Mukbil Shabani, (333)

hutlumtime jane ne nivel te knaqur qoft me gjuhen e perdor , shtjellimin e temes dhe perzgjedhjen e matreialti I cili I paraqitet lexuesit.

Munde te verhet duke u nisur nga natyra e revistees se shqyrtimet kane qene te kanalizuar deri ne nje mase qe korespodon me masen së ciles I deikohet revista dhe se shqyrtimet filozofike te ndonje qasje tjeter thuaje se nuk do te knishin vendin ketu dhe mendoj se revista do te jep nje tablo relativisht te qarte mbi kete discipline edhe pse ne te shumten e rasteve jo nga nje synim I percaktuar qe te rrjedhin studimet dhe shkrimet ne te sipas nje tabloje te qarte mirpo me shume nga perzdhedhje e vetë autoreve, per dallim nga studimet ne lemire e akaidit ku hasim ne nje laramani te nivelit te shqyrtimit dhe shkrimit e kunderta e kesaj ne shkrimet që trajtojne temat filozofike do te hasim ne nje nivel te larte akademik dhe shqyrtim te precizuar që jep nje vlere te vecante punimit.

Kronologjia e punimeve filozofike

1. Pikpamjet filozofike e religjioze – Ali Vishka (4/26)
2. Ndikimi I filozofise islame ne ate eurpojane – Muhamed Mustafa (5/38,39)
3. Islami dhe filozofia europjane – Nexhat Ibrahim (5/39,40)
4. Arabet dhe filozofia krishtere mesjetare – Avzi Mustafa (5/46) Perkthim
5. Filozofia islame – rejhan Neziri (5/45), perkthim
6. Lenda e filozofis islame – Rejhan Neziri (5/46,47), perkthim
7. Filozofia dhe Tseavufi – El Ehvani (7/49) perkthim R.N.
8. Filozofia dhe Fikhu – El Ehvani (7/50) perkthim R.N
9. Traktati mbi shpirtin Ibn Sina (59,60,61) perkthim M. Mustafa
10. Ngjajshmerit dhe dallimet e mendimeve filozofike – Hasn Shushiq, (66) perkthim
11. Teoria e njohjes sipas Ihvan Es Safa (69) M. Mustafa
12. Ndikimi ne fushen e filozofise – Zekerija Idrizi, (72, 74)
13. Filozofia islame , filozofi sinkretiste – Zekerija Idrizi, (75)
14. Reflekcioni I filozofise islame ne perendim - Ibrahim Madkur (77) perkthim
15. Kindiu dhe filozofia e tij M. Mustafa (78,79)
16. Traktati mbi intelektin – M. Mustafa (80)
17. Farabiu dhe filozofia e tij M. Mustafa (81,82,84,85)
18. Ibn Sina – M. Mustafa (124,125, 128,132)
19. Atributet e qenies se domosdoshme tek ibn Sina, Hamdi Thaci (129,130)
20. Mendimet filozofike, te ibn Sinase, Ferat Polisi (138)
21. Ibn Halduni dhe filozofia e historise – Zeki Arslan (140) perkthim
22. Filozofia islame domosdoshmeri apo trashegimi e padeshiruar – (188)
23. Feja, filozofia dhe gnosa – Hamdi Thaci (191)
24. Muhamed Ikbali filozof modern islam – Hamdi Thaci (200)
25. Veshtrim ne disa probleme te filozofise islame – N. Ibrahim (201)
26. Ndikimi ifilozofise islame ne perendim – Redaksia (203)
27. Emertimi I filozofise islame – N. Ibrahim (207)

28. Mendime filozofike dhe shkencore te ibn Sinase – Ferta Polisi (213,214,216,217)
29. Filozofia islame – Hasan Xhilo (305,306)
30. Vendi I filozofise islame ne kontekst me filozofine botrore – N. Ibrahimimi (321)
31. Estetika e mendimit filozofik islam – Redi Shehu, (323)
32. Filozofia dhe perfaqesuesit e sajë - H. Xhilo (325)
33. Platoni, mtezilitet, iluministet, - Mukbil Shabani, (333)

Komparacion ne mes te Revistes Hena e Re, Zani I Nalt dhe Edukata Islame

Nese I analizojm me vemendje do te shohim ne aspekt komparativ me te tri revistave Zani I Nalt, Edukata islame dhe Hena e Re do te shohim se megjith faktin se tematikat te cilat duhej te shqyrtohen ishin te njejta , do te verjem se cdonjera prej tyre do te jep qasjen e vet e cila korespodone me kohen dhe mases së cilës I drejtohej derisa ne faqet e Zanit te Nalt do te verejme nje koncentrimt te vecant reth ceshtjes se besimit dhe nevoja per besim dhe cka është besimi islam dhe kritika ndaj ateizmit dhe dukurtite qe shpiejn ne ted he shume pak tema filozofike, ku dominojne shkrimet autoriale, ne edukaten islame, do te shohim se prf. Sherif Ahmeti do te sjelle tema te larmishme here tema akaidologjike e here tjera komente te Kuranit Famëlartë dhe shtjellime akaidologjike dhe gjithsesi shqyrtime mbi frakcionet vecori do te jete botimi i veprave te perkthyer na Akaid si Fikh El Ekber, Akid En Nesefije te Imam En Nesefiut me spjegim të Teftazanit, Traktatit mbi besimin islam dhe te tjera e që nuk mungojne as temat filozofike sit e te filozofeve edhe te tematikave filozfike.

Sugjerim:

Prej numrit 153 deri në numrin 181 ka një shkputje të temave akaidologjike, gjithashtu shkuptje të këtill hasim prej numrit 238 deri 277. Shkaqet për këtë për mua janë të panjohura, por do t'i ishte e udhës që të mos kishte ndërprerje të këtilla nga se natyra e gazetës është e tillë që gjithmonë të ketë tema nga akaidologjia.

Disa herë në shqyrtime akaidologjike hasim studijues të rinj, student, të cilët i referohen nje libri të daves për një shtejllim akaidologjik dhe mundohen të trajtojnë tematika komplekse akaidologjike duke dashur që të kontribuojnë, por në fakt më shumë i bëjnë dëm akaidologjisë. Mbi të gjitha e tërë ajo që është shkruar në Hënën e Re rreth tematikave dhe shqyrtimve akaidologjike paraqet një pasqyrë të mirë të akaidit dhe një thesar të çmuar për studentët dhe hulumtuesit e kësaj fushe.

Konkludim:

-
- Në të ardhmen ne Revistë të ketë rubrikë të veçantë të standardizuar, ku në çdo numër të saj do te shtjellohen tematika akaidologjike qe do te jenë një nderlidhje zinxhirore ne disa numra qe ne funde te vitit prej tyre mund bëhet një broshurë me tematiak akaidologjike.
- Të shtjellohen tema akaidologjike te nderlidhura me problematika aktuale nga autorë profesional.
- Të konsultohen njohes të akaidit gjatë publikimit te tëmave akaidologjike.

Bibliografia:

- Abdu, Muhamed, *Hashijetun ala sherh el akaid el adu dijeti*, Kajro.
- Ahmeti, Sherif. *Kur'ani* (perkthim me komentim ne gjuhwn shqipe), Medine munevere.
- Behit: El Kavl el mufid fi lim et tevhid, Kairo, 1326.
- De Boer, T.J. (1957). *The History of philosophy in Islam*, perkthyeu Ebu Rejde. Kajro: Nehda el misrije.
- El-Bagdadi, Abdul Kahir. *El Ferku bejne el firek*, per[unoi Muhjidin Abdul Hamid. Kajro: Dar et turath, pa vit botmi.
- El-Eshari, Ebu Hasan. *El luma fi er red ala ehlu ez zejgi ve el bida*. perpunoj Hamude Gurab. Kajro. Mektebet el ez herije li et turath.
- El-Esh'ari, Ebu Hasan. (1980). *Mekalt el islamijin ve ihtilaf el musalin*. perpunoj Hellmut Ritter. Veisband: Xhemijet musteshrikin el alman.
- El-Eshari, Ebu Hasan,(1945). *Risaletu istihsanil havd fi ilm el kelam*. Hajdar Abad.
- El-Ijxhi, Adu din. (1998). *El Mevakif*. Bejrut: Dar el kutub el ilmije.
- Emin, Ahmed. (1973) *Duha el islam*. Kajro: En-nehda el misrije.
- Et-Teftazani, Sadu din. (2001). *Sherh el mekasid*. Bejrut: Dar el kutb el ilmije.
- Goldziher, Ignaz. (2014). *El akidetu ve esh sheriaru fi el islam* perktheu Muhamed Jusuf Musa, Alij Hasn Abdul Kadir, Abdul Aziz Hak. Kajro: Hejet el misrije lil kitab.
- Botimet e Bashkesise fterae islame ne RMV ne gjuhen shqipe (1984-2024) **nga Shaban RAMANI Shkup, 2024.**
- Izdanija na islamskata verska zaednica (makedonski, turski, bosanski, angliski I romski jazik od 1951-2024, autore Shaban Ramani, botoi Rijaseti Bashkesise fetrae islame 2024
- Bibliografi e Revistes “**Edukata Islame**” 1971- 2016, Ramadan Shkodra, Boton: Kryesia e Bashkesise Islame tw Republikws sw Kosovws, Prishtinw 2017
- Bibliografite e revistave “**Zani i Nalt**, Kultura islame, dhe Njeriu” Autor Faik Kasollja , Botimet Alsar, (Istanbull 2007).
- Fjalor I Filozofise, Ekrem Murtezai, toena, Tirane 2007
- Bashkesia Islame ne Maqedoni historiku dhe Funksioni, Dr. Mevuld Aliji, boton, Bashkesia fetare islame ne RMV, Shkup, 2023,
- Makedonya Vakiflari, Dr. Mumin Omerov, botn Bashkesia fetare islame, 2023.
- El Eshari, Hamude Gurbae, Perktheu, Dr,Abdilkrim Iseni, SHkup, 2021.

NDËRLIDHJA TEOLOGJIKE MIDIS KONCEPTIT “HALLALL” DHE BESIMIT NË ISLAM: NJË ANALIZË MBI NËNSHTRIMIN NDAJ VULLNETIT HYJNOR

Dr. Abdilkerim Iseni- Fakulteti I Shkencave Islame-Shkup

Abstract

Koncepti i *hallallit* në Islam përfaqëson më shumë se sa një rregullore mbi ushqimin apo sjelljen e lejuar. Ai është një komponent thelbësor i sistemit etik dhe normativ islam, i cili lidhet ngushtë me besimin (imanin) dhe përkushtimin ndaj Zotit.

Në këtë punim shkencor të titulluar **“Ndërlidhja Teologjike midis Konceptit 'Hallall' dhe Besimit në Islam: Një Analizë mbi Nënshtrimin ndaj Vullnetit Hyjnor”** të cilin po e paraqes para jush, do të shqyrtojmë marrëdhënien thelbësore ndërmjet hallallit dhe besimit në kontekstin teologjik islam, gjithënjë duke u mbështetur në burimet themelore islame si Kurani famelartë dhe hadithet e Muhamedit paqja dhe meshira e Zotit qoftë mbi të.

Qëllimi i këtij studimi është të tregojë se ndjekja e hallallit nuk është thjesht një akt formal, por një shprehje e bindjes së thellë dhe e ndërgjegjes së një besimtari që kërkon të jetojë sipas vullnetit hyjnor.

Hyrje

Ndër shkaqet që më nxiti të i rrekem këtij studimë është qasja dhe përshtypja të cilën e fiton kur flitet për standardin Hallall, është ajo qasje juridike islame (hallalli - harami) apo qasje gastronomike (Çfarë konsiderohet ushqim i shëndetshëm e çfarë jo? Cila është përqindja e lejuar? etj.) e deri të ajo tregtare dhe profitabile (tregu i Hallallit, sfidat, e ardhmja e tij ne botën islame dhe jashtë saj) dhe sikur gjithëçka rrotullohet në këtë aspekt formal të rregulloreve dhe dispozitave. **ÇFARË E PËRBEN HALLALLIN?**

Për mua si studiues i shkencave islame, me gjithë rëndësinë të cilën e kanë çdonjëra prej tyre në sferën e saj, sikur që esenca e cila qëndron pas këtyre mungon, ose pyetja e cila nga kjo qasje ngel pa përgjigje është: **CILI ËSHTË QËLLIMI FINAL I HALLALIT PËR MUA SI BESIMTAR MUSLIMAN? Pse duhet kushtuar kujdes hallallit?**

Ky studim synon, lexuesit dhe të intreseuarit për standardin dhe certifikimin Hallall t'i ofrojë ndërlidhejn e kuptimit të Hallallit dhe besimit islam, pra prapavijën e saj fetare duke i paraqitur faktet se Hallalli përfaqëson bindje dhe besim fetar para se të jetë një proces mekanik i ndërlidhur me rregullativa dhe standarde.

Nga këndvështrimi i një studijuesi islam që merret me shkencën e apologjetikës dhe besimit, dëshiroj të vë në pah atë që unë mund ta njoh si qëllim primar të hallallit është se ajo në islam paraqet bindje dhe besim që manifestohet me përkushtim në formën më të lartë të adhurimit e shprehur me shprehje të përcaktuara të fjalorit islam në këtë rast (hallall ose haram) dhe e tillë do të ngelet edhe më tej për çdo besimtar mysliman në çdo kohë dhe vend, duke mos i anashkuar edhe dimensionet tjera si ato etike, shëndetësore dhe ekonomike.

Studimi synon të hedh dritë mbi rëndësinë e certifikimit hallall si për ata që mirren me këtë lëmi gjithashtu edhe për konsumatorët duke e ndërlidhur atë me çështjen e besimit.

Qëllimi i punimit: struktura e punimit shkencor

Ky studim përbehet nga, hyrja dhe tre kapituj. Kuptimi i hallallit. Kuptimi i besimit dhe ndërlidhja e besimit me hallallin.

Në hyrje flitet për rëndësinë e temës në aspektin akademik dhe qëllimin të cilin synon të e arrijë studimi, gjithashtu metodën dhe tezat kryesore të studimit.

Pse është i rëndësishëm ky studim në kontekstin teologjik

Sipas teologjisë islame ai i cili ka të drejtën ekskluzive të vendosë rregullat dhe dispozitat është Krijuesi i gjithësisë nepërmjet shpalljes, pra Kuranit famëlartë dhe porosive të Muhamedit a.s. të shprehura në Hadithet e tij, e që nënkupton se e drejta e ligjvënies në islam i takon vetëm Zotit, pra edhe hallalli dhe harami si dispozita të legjislacionit islam ndërlidhen në menyrë të drejtpërdrejtë me atë.

Koncepti i hallallit, shikuar nga prizmi fetar përfshin të tre kategoritë të cilat i përmend i derguari i Allahut, Muhamedi a.s. në një thënie të tij: islamin, imanin dhe ihsanin.

Në aspektin akaidologjik paraqet bindje dhe besim ndaj urdhërave të Zotit e njohur si grada e imanit e që është të adhurosh Allahun, e njohur në kushtet e besimit, ndërsa në aspektin juridik të së drejtës islame (fikh) ajo është implementim i dispozitave fetare që bartin pasoja ligjore e që njihet me termin el islam, që përfshin pesë kushtet e islamit.

Në aspektin shpirtëror (ahlak) paraqet dashuri për t'i realizuar urdhërat fetare me përkushtim dhe pranim, të njohura si ihsan, që do të thotë të adhurosh Zotin dhe t'i përkushtohesh adhurimit të tij sikur e sheh, edhe pse nuk e sheh, Ai gjithësesi të sheh ty.

Kuptimi Teologjik i Konceptit 'Hallall' në Islam

Nuk do të ndalem në përkufizimin etimologjik dhe terminologjik të shprehjes Hallall dhe përkufizimin e saj në të drejtën islame nga bindja se kjo tanimë është shpjeguar dhe nuk kam çka të shtoj më tepër se ajo që është thënë, mirëpo pyetja e cila duhet elaboruar është kjo: Kush e definon dhe ka të drejtë të përcaktojë se çka është e lejuar dhe çka është e ndaluar? Kush e definon Hallallin dhe Haramin në islam?

Kush e definon hallallin

Lejimi dhe ndalimi janë e drejtë ekskluzive e Zotit xh.sh.!

Islami e ka përcaktuar autoritetin që ka të drejtë të lejojë apo të ndalojë dhe e ka shkëputur nga kompetenca e krijesave, pa marrë parasysh se çfarë pozite kanë në fenë e Zotit ose në botën e tyre, ngase këtë të drejtë e ka vetëm Zoti i Madhëruar. Kur'ani i qorton ithtarët e Librit (hebrenjtë dhe të krishterët), të cilët i autorizuan rabinët dhe murgjit e tyre për caktimin e hallallit dhe haramit. Në suren “Tëvbe”, Zoti i Madhëruar thotë: “Ata i konsideruan "ahbarët" (priftër jehudi) të tyre, "ruhbanët" (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos All-llahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj All-llahut një, e që nuk ka të adhurosh tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë.”

Adijj Ibn Hatemi erdhi të Pejgamberi a.s. (Adijj para se ta pranonte Islamin ishte i krishterë) dhe e dëgjoji se e lexonte këtë ajet dhe i tha: “O i dërguari i Zotit! Ata nuk i kanë adhurosh ata”. Pejgamberi iu përgjigj: “Gjithsesi, ata ua ndaluan hallallin dhe ua lejuan haramin, e ata i ndjekin. Ky është adhurimi i tyre.”¹³⁴

Sipas një transmetimi tjetër, Pejgamberi a.s. duke e komentuar këtë ajet ka thënë: “Ata edhe pse nuk i adhuronin, e pranonin si hallall atë që ua lejonin dhe si haram atë që ua ndalonin”.

Krishterët ende supozojnë se Isai a.s. para Kur'anit apo Pejgamberit të Tij, dhe vetëm ata janë të autorizuar ta sqarojnë vendimin e Zotit për të ndaluar dhe lejuar. “E Ai ju sqaroi juve se çka është e ndaluar për ju!” (El-En'âm, 119)

134

Dijetarët abstenonin të prononcohen se kjo është e lejuar apo e ndaluar “Njoh dijetarë të mirëfilltë që me vështirësi japin fetva, gjegjësisht urrejnë të thonë se “kjo është e lejuar e kjo e ndaluar”,përveç asaj që është e qartë në Kur’anin e Zotit dhe që s’ka nevojë për koment.”

Koncepti i Hallallit sipas mësimave islame para se të jetë lidhshmëri me njerëzit ajo është lidhshmëri me Zotin dhe gjithmonë do të ngelet e tillë. Diçka është hallall, pra e dashur, e pelqyer dhe e urdhëruar prej dhe tek Zoti ose në të kundërtën është haram e urreyer, jo e pelqyer dhe e ndaluar nga dhe tek Zoti.

Përkufizimi i imanit (besimit) dhe kuptimi i tij

Me shprehjen iman/besim nënkuptojmë besim të paluhatshëm dhe pranim të të gjithë atyre gjërave në të cilat Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë urdhëruar të besojmë, si dhe nënshtrim ndaj ligjit të Allahut, në të dukshmen dhe të padukshmen. Pra ai është konfirmim dhe besim i zemrës, që përmban veprat e zemrës dhe veprat e trupit, e kjo përfshin kryerjen e të gjitha veprave fetare.

Ai është fjalë, vepër dhe besim, shtohet me nënshtrim ndaj Zotit dhe të Dërguarit të Tij dhe pakësohet me mëkatim ndaj tyre. Duke u nisur nga kjo, imani përmban besimin, moralin dhe veprat.

Raporti i besimit me praktikën fetare

Në islam, besimi dhe praktika janë të ndërlidhura shumë fortë mes veti saqë nuk mund të ketë besim të sigurt që do t’i plotësojë kushtet e besimit nëse ai nuk manifestohet me vepra. Me termin vepra nënkuptojmë çdo fjalë, sjellje ose veprim aktiv. Në Kuranin famëlartë besimi dhe vepra e mirë janë të ndërlidhura fortë. Zbatimi i çdo hallalli do të thotë bindje e thellë në vërtetësinë e tij dhe në të njëjtën kohë dëshmi e besimit dhe e kundërta, zbatimi i ndonjë harami konsiderohet jo vetëm mëkat por edhe shenjë e mosbindjes dhe sinjal i fetarizmit të dobët të individit ndaj parimeve dhe urdhërave fetare.

1. Ndërlidhja midis Hallallit dhe Besimit :Hallalli në jetën e përditshme të besimtarit

Kur flasim për hallallin dhe jetën e përditshme të besimtarit sdo mend se ajo përfaqëson tërë konceptin e tij për jetë. Pra besimtari është i obliguar të jetojë jetën sipas parimeve islame dhe të veprojë vepra të mira dhe të ndalohet nga veprat e këqija.

Hallalli gjithsesi është pasojë e besimit të sinqertë që manifestohet me nënshtrim ndaj urdhrave hyjnore si shprehje e imanit dhe shenjë e rëndësishme që dëshmon ndërgjegjen fetare tek individit dhe shoqëria në përzgjedhjen e hallallit gjatë tërë jetës si në të jetuarit, ushqyerit dhe komunikimin. Hallalli është një jetë e tërë.

Përse ushqimi hallall është koncept imanor dhe i ndërlidhur me besimin?

Përgjigjen e kësaj pyetje do ta ilustroj me një thënie të Muhamedit a.s..Transmeton Enesi, r.a. të thotë se: I thashë të Dërguarit të Allahut:"O i Dërguari i Allahut! Dua që të më pranohen lutjet”!

I Dërguari i Allahut, s.a.v.s. më tha: "O Enes, fito hallall, vishu me hallall dhe ha nga hallalli, sepse atij që e ka rrobën prej haramit dhe atij që e ka ushqimin haram në stomak, nuk i pranohet adhurimi dyzet ditë!”

Ushqimi haram e shkatërron një brez të tërë dhe e shkatërron shoqërinë.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë:"...Njëriu ngre duart drejt qiellit dhe lutet: “O Zot, o Zot! Por, gjërat që ka ngrënë, pirë dhe veshur janë haram. Si t'i pranohet lutja një njëriu të tillë?" (Muslim, Zekat, 19; Tirmidhi, 661; Bejheki, Sunen, 6187.)

Ngrënia e ushqimit të mirë e hallall ka ndikim të madh në **pastërtinë e zemrës** (që është cilësi e besimit të sinqertë), **në përgjigjen e lutjes** dhe **pranimin e adhurimit**, ashtu siç edhe **ngrënia e haramit bëhet pengesë për pranimin e saj**.

Ai që ushqehet me haram Allahu nuk ka se si t'ia pastrojë zemrën dhe as nuk do t'i përgjigjet lutjes së tij! Profeti s.a.v.s. ka thënë: “O ju njërëz! Allahu është i mirë dhe pranon vetëm të mirën. Allahu i ka urdhëruar besimtarët ashtu siç i ka urdhëruar Profetët, Ai ka thënë: “O të dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira!” (el-Mu'minun: 51) dhe ka thënë: “O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë” (el-Bekare: 172)

Pra, nëse lutja është forma më e lartë e adhurimit dhe ajo është kushtëzuar të pranohet vetëm nga Hallalli, a nuk është kjo dëshmi e lidhshmërisë së besimit me hallallin.**Sfidat moderne dhe interpretimet bashkëkohore**

Pa dyshim se koncepti hallall po përballlet me shumë sfida për të cilat nevojitet një përkushtim edhe më i madh dhe më serioz në vënien e prioriteteve, posaçërisht nëse flasim nga këndvështrimi ynë parcial.

- **Mosnjohja adekuatë e rëndësisë së Hallalit në këtë nënqiell**

Ajo që i mungon besimtarit musliman sot në kohën moderne është rëndësia fetare e certifikimit Hallall si individ dhe shoqëri, ndërsa lidhshmëria e saj me besimin do të kontribuojë jo pak në rikthimin e vetëdijes për konceptin hallall si lëmi në vete.

- **Rroli edukativo shpirtëror në vetëdijen e rinisë për standardin Hallall**

Në fund mund të themi, tërë atë që në botën moderne përmban certifikimi hallall pa dyshim se ngel një çështje reth së cilës duhet të kemi kujdes dhe assesi të mos na përvidhet ndonjë lëshim apo të tolerojmë tejkalim të normave të Hallallit, sepse në fund të fundit Standardi Hallall paraqet qëllimin më të lartë dhe më sublim që nënkupton zbatimin e udhezimit fetar se certifikimi hallall është fe dhe duhet të trjatohet si i tillë.

Pra, shprehja Hallall në fjalorin islam lidhet ngushtë me konceptin e **besimit dhe etikës në Islam**. Kur dikush thotë "**hallall**", zakonisht nënkupton se diçka është e lejuar, e drejtë dhe në përputhje me normat fetare islame. Besimtarët muslimanë përpiqen të jetojnë një jetë "**hallall**", që do të thotë: Të hanë ushqime të lejuara (jo mish derri, jo alkool, etj.). Të fitojnë para në mënyrë të ndershme (jo përmes mashtrimit, bixhozit, ose kamatës). Të kenë marrëdhënie të ndershme dhe korrektë me njëri-tjetrin në rafshin shoqëror.

Hallalli përfaqëson edhe ndërgjegjen e besimtarit musliman. Pra, një musliman i devotshëm shpesh pyet vetën: "A është kjo gjë hallall për mua?" — që lidhet drejtpërdrejt me ndërgjegjen fetare dhe besimin në Zot. Është një formë e vetëkontrollit dhe ndershmërisë që padyshim buron nga besimi.

Hallalli gjithashtu manifestohet edhe në marrëdhëniet ndërnjërëzore, kur një person e falë dikë për një padrejtësi dhe thotë: "*Ta kam bërë hallall*", kjo nënkupton një akt faljeje të sigurtë për hir të Zotit, duke i dhënë rëndësi harmonisë dhe mëshirës, që në esencë paraqet poashtu një urdher fetar.

Në thelb, "hallalli" nuk është vetëm çështje ushqimi apo rregullash, por një qasje jetësore që ndikohet nga besimi dhe qëllimi për të jetuar në përputhje me vlerat morale dhe shpirtërore të urdhëruara nga Zoti i gjithësisë.

Ky studim synon të hedhë dritë mbi rëndësinë e certifikimit hallall si për ata që mirren me këtë lëmi gjithashtu edhe me konsumatorin duke e ndërlidhur me çështjen e besimit. Pra, sikur që

paraqet element fetar dhe bindje ne përcaktim certifikimi hallall i një produkti, gjithashtu edhe për konsumatorin mysliman përzgjedhje mes produkteve, që do të shërbejë si një lloj fetarizmi dhe bindje besimore që nuk guxon të anashkalohet

Perfundim

Ky punim u dedikhet: Konsumatorëve, drejtorive dhe institucioneve për certifikim hallall.

Nëse certifikimin hallall e largojmë nga përdoruesit jomusliman ai do të paraqesë një veti dhe atribut fetar, dhe me vënien e logos Hallall në produkt praktikisht jep “Garancë” për përmbushjen e kriterëve dhe kjo ngel vetëm çështje kriteresh apo duhet të bart në vete shpirtin sheriatik? Unë do të konsideroj certifikimin hallall një fetva dhe dispozitë fetare dhe sipas mendimit tim të gjitha agjencionet për certifikim hallall duhet ta trajtojnë këtë jo vetëm si çështje rregullash të cilat përmbushen apo jo dhe kriterë të cilat mund të jenë të ndryshëm në kuptimin, përcaktimin dhe cilësimin e tekstit të shenjtë.

Bibliografia:

- Ahmeti, Sherif. *Kur'ani* (perkthim me komentim ne gjuhwn shqipe), Medine munevere.
- De Boer, T.J. (1957). *The History of philosophy in Islam*, perkthyeu Ebu Rejde. Kajro: Nehda el misrije.
- El-Eshari, Ebu Hasan. *El luma fi er red ala ehlu ez zejgi ve el bida*. perpunoit Hamude Gurab. Kajro. Mektebet el ez herije li et turath.
- El-Ijxhi, Adu din. (1998). *El Mevakif*. Bejrut: Dar el kutub el ilmije.
- Emin, Ahmed. (1973) *Duha el islam*. Kajro: En-nehda el misrije.
- Botimet e Bashkesise fterae islame ne RMV ne gjuhen shqipe (1984-2024) **nga Shaban RAMANI Shkup, 2024.**
- Izdanija na islamskata verska zaednica (makedonski, turski, bosanski, angliski I romski jazik od 1951-2024, autore Shaban Ramani, botoi Rijaseti Bashkesise fetrae islame 2024
- Bibliografi e Revistes “**Edukata Islame**” 1971- 2016, Ramadan Shkodra, Boton: Kryesia e Bashkesise Islame tw Republikws sw Kosovws, Prishtinw 2017
- Bibliografite e revistave “**Zani i Nalt**, Kultura islame, dhe Njeriu” Autor Faik Kasollja , Botimet Alsar, (Istanbul 2007).
- Fjalor I Filozofise, Ekrem Murtezai, toena, Tirane 2007
- Bashkesia Islame ne Maqedoni historiku dhe Funksioni, Dr. Mevuld Aliji, boton, Bashkesia fetare islame ne RMV, Shkup, 2023,
- Makedonya Vakiflari, Dr. Mumin Omerov, botn Bashkesia fetare islame, 2023.
- El Eshari, Hamude Gurbae, Perktheu, Dr,Abdilkrim Iseni, SHkup, 2021.